

*Kah gjenerata e 2<sup>-të</sup> e*  
**Reformave në Sektorin e**  
**Sigurisë në MAQEDONI**



analytica   
thinking laboratory...

Andreja Bogdanovski | Magdalena Lembovska


SHKUP  
2012



*Kah gjenerata e 2-të e*  
**Reformave në Sektorin e**  
**Sigurisë në MAQEDONI**

Andreja Bogdanovski | Magdalena Lembovska

SHKUP  
2012



Dame Gruev 7/8-3, 1000 Shkup, Maqedoni

Tel/Fax: +389 2 312 1948

e-mail: [info@analyticamk.org](mailto:info@analyticamk.org)

**Autor:**

Andreja Bogdanovski | Magdalena Lembovska

**Dizajn:**

Muhsin Güler

Ky botim fillimisht u zhvillua në suaza të projektit hulumtues “Ndërtimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për mapim dhe vëzhgim të reformave në sektorin e sigurisë në Ballkanin perëndimor, 2009- 2011”. Ky projekt rajonal ka përfshirë 7 “think-tank” organizata rajonale nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia, financiarisht i përkrahur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë. Projekti u zhvillua në bashkëpunim me Qendrën për Kontroll Demokratik të Forcave të armatosura të Gjenevës, (K DFA) ([www.dcaf.ch](http://www.dcaf.ch)). Metodologjia për mapim dhe vëzhgim të reformave në sektorin e sigurisë u zhvillua nga Qendra për Politika Sigurie e Beogradit ([www.bezbednost.org](http://www.bezbednost.org)). Ky botim financiarisht është përkrahur nga K DFA.

© Copyright 2012



Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose ndryshohet pa pëlqimin paraprak nga autorët.

## AUTORE

**Andreja Bogdanovski** ka punuar si Bashkëpunëtor i Hulumtimeve të Sigurisë në Analytica Think Tank prej vitit 2009. Ai ka titullin e magjistrin në Shkenca Politike nga universiteti i parë privat në Shkup, FON. Hulumtimi i tanishëm përqendrohet në Reformat e Sektorit të Sigurisë në Maqedoni (institucionet e pavarura shtetërore dhe kontrolli ekzekutiv). Veç kësaj, ai punon në transformim të konflikteve në Ballkanin Perëndimor dhe në veçanti, në vlerësimin e nivelit të rajonit në drejtim të sigurisë në bashkësi. Bogdanovski është autor i disa studimeve mbi qeverisjen demokratike dhe reformën e sektorit të sigurisë në Maqedoni.


Mund ta kontaktoni në: [abogdanovski@analyticamk.org](mailto:abogdanovski@analyticamk.org) ose [bogdanovski.a@gmail.com](mailto:bogdanovski.a@gmail.com)

**Magdalena Lembovska** e diplomuar në Shkenca Politike dhe kandidat i magjistraturës në Siguri dhe Kontroll Financiar. Punon si bashkëpunëtoresh hulumtuese në Programin për Politika të Huaja dhe të Sigurisë në Analytica, ku merret me çështjet bashkëkohore të sigurisë dhe konceptin e qeverisjes së mirë. Ajo përqendrohet në: reformat e sektorit të sigurisë, procesin e demokratizimit, migracionin e paligjshëm, kontrollin financiar dhe vëzhgimin e institucioneve nga sektori i sigurisë.

Mund ta kontaktoni në: [mlembovska@analyticamk.org](mailto:mlembovska@analyticamk.org).

# PËRMBAJTJA

*Kah gjenerata e 2-të e*  
**Reformave në Sektorin e**  
**Sigurisë në MAQEDONI**



<b>Lista e shkurtesave</b>	8
<b>Hyrja</b>	9
<b>Kontrolli i brendshëm</b>	11
	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>
<b>1   Legislation</b>	12
1.1   Ministria e punëve të brendshme	13
1.2   Ministria e mbrojtjes	14
1.3   Agjencia e zbulimit	16
<b>2   Kapacitetet për zbatim dhe administrim</b>	17
2.1   Ministria e punëve të brendshme	17
2.2   Ministria e mbrojtjes	23
2.3   Agjencia e zbulimit	25
<b>3   Vlera</b>	27
<b>4   Rekomandime</b>	29
<b>Kontrolli i buxhetit</b>	30
	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>
<b>1   Legjislatura</b>	31
1.1   Menaxhimi financiar dhe kontrolli (MFK)	32
1.2   Revizioni i brendshëm	33

1.3   Harmonizimi i Kontrollit të brendshëm dhe Revizionit të brendshëm – Departamenti i Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik	35
2   <b>Praktika</b>	36
3   <b>Kapaciteti administrativ</b>	39
4   <b>Vlerat</b>	42
5   <b>Rekomandimet</b>	43
<b>Kontrolli parlamentar</b>	44
	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>
1   <b>Kontrolli dhe Vëzhgimi</b>	45
1.1   Kontrolli i buxhetit	45
A   <i>Legjislatura</i>	45
B   <i>Praktika</i>	47
1.2   Kontrolli i përputhjes së punës me ligjet dhe respektimi i të drejtave të njeriut	49
A   <i>Legjislatura</i>	49
B   <i>Praktika</i>	50
1.3   Kontrolli dhe vëzhgimi i zbatimit të politikave qeveritare dhe ligjeve të miratuar nga parlamenti	54
A   <i>Legjislatura</i>	54
B   <i>Praktika</i>	55
1.4   Kontrolli dhe vëzhgimi i sigurisë bilaterale dhe multilaterale	56
A   <i>Legjislatura</i>	56
B   <i>Praktika</i>	57
2   <b>Kapaciteti administrativ</b>	58
3   <b>Vlerat</b>	60
4   <b>Rekomandime</b>	61
<b>Bibliografia</b>	62
<b>Shtojca 1</b>	68
<b>Shtojca 2</b>	69



*Kah gjenerata e 2-të e*

**Reformave në Sektorin e Sigurisë në MAQEDONI**

## **Lista e shkurtesave**

BSP –Byroja për Siguri Publike

KPT- Komiteti i Këshillit Evropian për Parandalimin e Torturës

CSD-Komiteti për Siguri dhe Mbrojtje

KDFA- Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura

DSKZ- Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim

BE- Bashkimi Evropian

KFB- Komitet i Financave dhe Buxhetit

MFK- Menaxhimi financiar dhe kontrolli

AZ- Agjencia e Zbulimit

ANTHP- Asistenca Ndërkombëtare për Trajtime për Hetime Penale

MB- Ministria e Mbrojtjes

MPB- Ministria e Punëve të Brendshme

D- Deputet të Parlamentit

PKMAQ- Programi Kombëtar për Miratimin e Acquis Communautaire

EKR- Enti Kombëtar i Revizionit

PPQM- Përkrahje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit

(L)KBFP- (Ligji mbi) Kontroll të Brendshëm Financiar Publik



## Hyrje

Shpërbërja e qetë nga Jugosllavia komuniste në vitet e 90-ta, së bashku me përvojat nga konflikti i brendshëm i armatosur në vitin 2001 dhe përpjekjet për hyrje në BE dhe NATO, e bëjnë Maqedoninë një rast mjaftë interesant për vëzhgim të mënyrës së zhvillimit të sektorit të sigurisë, dhe nëse ka arritur sukses në institucionalizimin e praktikave të mira.

Ky dokument i politikave, pra, synon identifikimin e tendencave, dhe sfidat kryesore për qeverisjen e sektorit të sigurisë së Maqedonisë në periudhën 2009 - 2012 që gjenden në tre fusha: jashtë (përmes Parlamentit), brenda (me anë të kontrollit të ekzekutiv) dhe së fundi, kontrolli mbi shpenzimin e fondeve publike.

Autorët e këtij botimi përpiqen të hedhin dritë mbi fazën në të cilën Maqedonia ka përparuar në zbatimin e brezit të dytë të reformave në sektorin e sigurisë, të identifikuara nga Timothy Edmunds si «konsolidim i reformave të mëparshme, si dhe funksionimin efektiv dhe efikas të institucioneve dhe procedurave me çmim të qëndrueshëm për shtetin dhe shoqërinë.»<sup>1</sup>

Në Kapitullin 1 të këtij botimi, theksi është vënë në mënyrën e ushtrimit të kontrollit të brendshëm dhe vëzhgimit në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe Agjencisë së Zbulimit. Kapitulli 2 shqyrton zbatimin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, si një vegël thelbësore për ushtrim të vëzhgimit të brendshëm buxhetor. Së fundi, Kapitulli 3 ka Parlamentin si një pikë vëzhgim, por në të njëjtën kohë edhe si organ ligjvënës dhe analizon punën e tij në katër fusha kryesore të zbatueshme për sektorin e sigurisë: buxhetim, të drejtat e njeriut, zbatimin e politikave qeveritare, si dhe vëzhgimin e parlamentit mbi bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh të sigurisë dhe integrimi të shtetit.

Përfundimet e këtij botimi janë rezultat i një projekti tre vjeçar “Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile për Mapim dhe Vëzhgim të Reformave në Sektorin e Sigurisë në

---

1 | Edmunds, Timothy (2003) 'Reforma e Sektorit të Sigurisë: Koncepte dhe Zbatimi', në Wilhelm N.Germann and Timothy Edmunds (eds) Drejt Reformave të Sektorit të Sigurisë në Evropën e pas luftës së ftohtë: Kornizë për Vlerësim. Baden Baden: Nomos, f. 11.



Ballkanin Perëndimor” të zhvilluara nga një partneritet prej shtatë think tank rajonal në Ballkanin Perëndimor. Projekti përfundoi me shtypjen e disa botimeve të politikave: 1) Almanak i Reformave në Sektorin e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 2) Analizë e Kontekstit të Reformave në Sektorin e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 3) Politikat e Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, dhe në rastin e Maqedonisë 4) Transparenca e Sektorit të Sigurisë.

Hulumtimi kryesisht është bazuar në metodologji<sup>2</sup>, e zhvilluar nga Qendra për Politika të Sigurisë në Beograd, dhe më tutje është shtuar me punën e gjashtë think tank organizatave tjera në projekt (përfshirë Analytica). Pjesa më e madhe e të dhënave të mbledhura për këtë botim reflekton periudhën prej vitit 2009 dhe 2012, dhe është ndërtuar mbi intervista cilësore të ekspertëve, krijues të politikave dhe akademikë, sikur edhe me deputet dhe zyrtar të qeverisë. Përfundimet e këtij botimi gjithashtu paraqiten si rezultat i mbledhjes së të dhënave të siguruara me përdorimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione të Karakterit Publik.

Duam të shprehim falënderim për mbështetje Qendrës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë (K DFA) dhe Qendrës për Politikë të Sigurisë në Beograd, për menaxhim të projektit dhe sigurim të informatave kthyesë të vlefshme. Veç kësaj, duam të shprehim mirënjohjen tonë për Z. Rade Rajkovçevski, i cili me ne ka ndarë mendimet e tija të vlefshme dhe ekspertizë të jashtme për versionet e hershme të këtij botimi.

Ky botim duhet përfundimisht të jep kontribut për një kuptim më të mirë të tipareve kryesore të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe vëzhgimit mbi sektorin e sigurisë të Maqedonisë dhe të plotëson zbrazëtirën e literaturës që ekzistojnë në këtë fushë. Veç kësaj, listat e rekomandimeve në fund të botimit kontribuojnë në përdorimin praktik të botimit, duke ofruar rekomandime të qarta dhe realiste, që mund të drejtojnë kah mangësitë më parë të identifikuara.

---

2 | Më tepër detaje mbi metodologjinë mund të gjendet në “Almanaku mbi reformat e sektorit të sigurisë në Ballkanin Perëndimor” f. 241, mund të gjeni edhe në: [http://www.analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://www.analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)

# Kontrolli i brendshëm

## Përmbledhje e ekzekutive

Legjislacioni primar që rregullon kontrollin e brendshëm brenda aktorëve të sektorit të sigurisë (Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Zbulimit) është i pamjaftueshëm dhe si i tillë kryesisht rregullohet me shumë akte nënligjore (lëshuar nga ministri përkatës). Të gjitha institucionet e sektorit të sigurisë kanë krijuar mekanizma të ndryshëm për kryerjen e kontrollit të brendshëm.

Ministria e Punëve të Brendshme ka themeluar Sektorin për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SKBSP) që merret me parashtrësat e qytetarëve. Numri i parashtrësave të paraqitura ka tendencë të rritjes nga viti në vit, që mund të tregojë se Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale ka fituar besimin e qytetarëve, por nga ana tjetër, mund gjithashtu të tregojë edhe rritje të numrit të rasteve kur qytetarët përballen me trajtim të papërshtatshëm nga ana e policisë.

Ministria e Mbrojtjes zhvillon kontrollin e brendshëm me anë të inspektorëve në mbrojtje që kanë kontrolluar nëse përmbushja e detyrave të të punësuarve është në përputhje me ligjet përkatëse. Habit fakti se sipas Ministrisë së Mbrojtjes, nuk ka të dhëna për nisje të procedurave disiplinore, kundërvajtjeve ose procedurave penale ndaj punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes. Përveç inspektimit, ekziston edhe mundësia që qytetarët të paraqesin parashtrësat dhe propozimet tek Ministria e Mbrojtjes.

Nga ana tjetër, Ligjit për Agjencinë e Zbulimit i mungojnë edhe dispozitat themelore që rregullojnë kontrollin e brendshëm. Posti i Inspektorit të Përgjithshëm në kuadër të Agjencisë për Zbulim u anulua në vitin 2000 për shkak të racionalizimit të fondeve, dhe kontrolli i brendshëm kryhet nga një komisionit disiplinor.



## 1| Legjislatura

Ligjvënësit kanë një tendencë për të qenë sa më të paqartë kur bëhet fjalë për kontrollin e brendshëm në sektorin e sigurisë (Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Zbulimit). Pothuajse të gjitha ligjet primare ofrojnë informata të pamjaftueshme mbi mënyrën e kryerjes së kontrollit. Kjo fushë rregullohet me akte nënllogjore, të cilat zakonisht janë më larg syve të publikut. Një institucion që qëndron jashtë kësaj është MPB, që ka shpallur rregullat dhe procedurat e saja në internet.

Kushtetuta përcakton se çdo qytetar ka të drejtë të paraqet parashtresë në institucione shtetërore dhe entitete tjera të sektorit publik dhe të fiton përgjigje për atë<sup>3</sup>. Ligji për Punë të Brendshme themelon një njësi të veçantë që merret me parashtresat e qytetarëve dhe profesionalizmit në punën e të punësuarve në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme<sup>4</sup> (Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale). Në rastin e Ministrisë së Mbrojtjes, kontrolli mbi ligjshmërinë e veprimeve në lidhje me mbrojtjen kryhet nga inspektorët e mbrojtjes.

Kompetencat që ju jepen organeve të brendshme, me të drejtën e ushtrimit të kontrollit ligjor janë të mjaftueshme për të kryer kontrollin themelor. SKBSP pranë MPB dhe inspektorët e mbrojtjes brenda Ministrisë së Mbrojtjes kanë qasje të lirë në të dhëna dhe objekte që janë të nevojshme për punën e tyre efektive, dhe të gjithë punonjësit duhet të bashkëpunojnë dhe ti sigurojë ato me të gjitha dokumentet dhe informatat për të cilat ata kanë nevojë.<sup>5</sup> Ministrat (si për punë të brendshme dhe për mbrojtje) kanë të drejtë të iniciojnë kontroll të brendshëm në njësi të caktuara të Ministrisë, si dhe të drejta për të dhënë udhëzime dhe direktiva.

---

3 | Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52/91, Neni 24 mund të gjeni edhe në: <http://www.sobranie.mk/en/default-en.asp?ItemID=9F7452B-F44EE814B8DB897C1858B71FF>

4 | Ligji për Punë të Brendshme [Law on Internal Affairs]. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 92/2009, Neni 38

5 | Për MM: Ligji për Mbrojtje – teksti i spastruar [Law on Defence – consolidated text] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 185/11, Neni 166

## 1.1 | Ministria e Punëve të Brendshme

Ligji për Punë të Brendshme parashikon kontrollin e brendshëm dhe të jashtëm mbi punën e tij<sup>6</sup>. Derisa kontrolli i jashtëm kryhet nga Parlamenti dhe Avokati i Popullit<sup>7</sup> kontrolli i brendshëm në Ministrinë e Brendshme kryhet nga Sektori për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale (SKBSP). Ky sektor ka kompetenca mbi të gjitha departamentet e Ministrisë, duke përfshirë edhe Byronë për Siguri Publike dhe Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim<sup>8</sup>. Kompetencat konkrete dhe mënyra e zhvillimit të kontrollit të brendshëm janë përcaktuar në aktin nënligjor - Rregullat dhe rregulloret e SKBSP<sup>9</sup>.

Përveç kësaj, Ligji për Policinë<sup>10</sup> rregullon mënyrën e kryerjes së punës policore, duke përshkruar qartë rastet kur të punësuarit e policisë mund të përdorin autorizimet policore dhe në këtë mënyrë të kufizojnë liritë e qytetarëve.

Kreu i SKBSP është i pavarur nga njësitë tjera organizative në kuadër të MPB dhe drejtë përgjigjet Ministrit, që shton rëndësinë e përgjithshme të dhënë kësaj njësie organizative. Kreu i SKBSP emërohet nga Ministri. Përveç kësaj, duke i dhënë rëndësi pavarësisë, hapësirat e SKBSP nuk janë të vendosura në ndërtesën e MPB, por në një ndërtesë tjetër pranë saj.

Sa i përket kompetencave, SKBSP vepron sipas detyrës zyrtare, sipas të dhënave të grumbulluara në bazë të parashtresave të qytetarëve, dokumentacionin e brendshëm dhe të dhënat nga të punësuarit e MPB, ose me urdhër të Ministrit të Brendshëm. Shefi i SKBSP njofton Ministrin për të gjitha rastet kur janë gjetur shkelje, dhe gjithashtu edhe Drejtorin e njësisë organizative të cilës i takon. Vendimet e SKBSP janë të detyrueshme

---

6 | Ligji për Punë të Brendshme [Law on Internal Affairs]. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 92/2009, Neni 37

7 | Ibid, Neni 39

8 | Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për skemën organizative të MPB.

9 | Mund të gjeni edhe në <http://www.mvr.gov.mk/Uploads/pravilnik%201SVKPS%20konecna%20verzija.doc>

10 | Ligji për Polici [Law on Police] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.114/2006



për të punësuarit në MPB, dhe nëse ata nuk plotësohen, kjo imponon sanksione disiplinore<sup>11</sup>. Nëse ka prova të një vepre penale, Prokurori Publik dhe Sektori për Hetimin janë të informuar<sup>12</sup> që të mund të fillojnë me hetim.

Përveç kësaj, kontrolli i brendshëm në kuadër të Byrosë për Siguri Publike rregullohet me Procedura dhe Praktika Standarde për Vëzhgim dhe Kontroll të Aktit Policor, që ofrojnë udhëzime për personat (kreu i njësisë) me kompetenca për të kryer kontrollin dhe llojet e kontrollit. Këto procedura janë të bazuara në legjislacionin ekzistues dhe nuk sjellin detyrime të reja, por më tepër konsiderohen si mjete ndihmëse për sigurim të zbatimit efikas të dispozitave të kontrollit. Rekomandohet që kontrolli dhe vëzhgimi të kryhen në çdo nivel të Byrosë për Siguri Publike, dhe së paku një herë në 4 vjet drejtori i Byrosë për Siguri Publike duhet të kryen vëzhgimin e përgjithshëm. Paraqet një vëzhgim dhe kontroll të përgjithshëm<sup>13</sup> (inspektim) mbi ecurinë e përgjithshme të një departamenti, me qëllim që të sigurohet ligjshmëri, profesionalizëm, cilësi, efikasitet dhe përputhshmëri të veprimeve me qëllimet afatmesme apo afatgjata dhe planet operative. Ajo mund të urdhërohet nga drejtori i Byrosë për Siguri Publike.

## 1.2 | Ministria e Mbrojtjes

Korniza ligjore që rregullon kontrollin e brendshëm në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes mjafton për zhvillimin e kontrollit të duhur. Megjithatë, mënyra e vetme e planifikimit sipas Ligjit për Mbrojtje, është inspektimi i zbatimit të ligjit për mbrojtje dhe rregulloret tjera relevante në fushën e mbrojtjes. Inspektimi nuk kryhet vetëm brenda, por zhvillohet edhe në institucionet tjera shtetërore, ndërmarrje publike, shërbime të rëndësishme të madhe për mbrojtje, komunat lokale, etj<sup>14</sup>. Inspektorët e mbrojtjes kanë të drejtë të japin rekomandime dhe propozime për parregullsi të zbuluara dhe nëse ata nuk janë

---

11 | Të dhëna të marra me Qasjen e lirë të informatave

12 | Rregullorja për Kryerjen e Punëve të SKBSP [Rules and regulations of SICPS], Neni 10

13 | Procedura Standarde dhe Procedura për kryerjen e vëzhgimit dhe kontrollit në polici [Standard procedures and practices for oversight and control of the Police], pika 11

14 | Ligji për Mbrojtje – teksti i spastruar [Law on Defence – consolidated text] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 185/11, Neni 163

të mënjauara, ose nëse inspektori i mbrojtjes konsideron shkeljen e rregulloreve si vepër penale ose kundërvajtje, ai/ajo është i/e obliguar të dorëzon kërkesë për fillimin e procedurës së përshtatshme – penale ose kundërvajtje.

Veç kësaj, Ligji për Mbrojtje gjithashtu i drejtohet Ligjit për Inspektim<sup>15</sup> si akt përkatës i legjislacionit që duhet konsultuar. Megjithatë, dispozitat në të dy ligjet janë pak a shumë të njëjta dhe nuk përcaktojnë procedura të ndryshme për kryerjen e inspektimit të mbrojtjes krahasuar me inspektimet në fusha tjera.

Ndryshimet e Ligjit për Mbrojtje nga prill 2011<sup>16</sup>, imponojnë raporte tremujore inspektive të kryera, të cilat duhet të shpallen në ueb-faqen e Ministrisë së Mbrojtjes mbi inspektimet e kryera. Kjo është hera e parë që një aktor i sektorit të sigurisë të bëhet subjekt i një detyrimi ligjor, për të shpallur në internet raporte mbi inspektimet e kryera. Ekzistojnë tri lloje të inspektimit, të parapara në Ligjin për Mbrojtje<sup>17</sup>:

- Të rregullta – inspektive mbi pajtueshmërinë e veprimeve me legjislacionin përkatës në mbrojtje, të kryera sipas një programi vjetor të përcaktuar nga Ministri i Mbrojtjes..
- Të jashtëzakonshme – si rezultat i kërkesës nga ministri, institucioni shtetëror, institucion ose individ tjetër, ose pas një raporti të inspektorit të mbrojtjes - kur dyshohet se ka parregullsi.
- Kontrolluese – kontrollohet nëse parregullsitë e paraqitura janë zgjedhur.

---

15 | Ligji për Inspektim [Law on Inspection] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.50/10

16 | Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Mbrojtje [Law Amending the Law on Defence] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.51/11

17 | Ligji për Mbrojtje – teksti i spastruar [Law on Defence – consolidated text] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 185/11, Neni 165



Në pajtim me Ligjin për Veprim sipas Propozimeve dhe Parashtresave<sup>18</sup>, MM është e detyruar të emërojë një person ose të themelon një njësi përgjegjëse organizative për të vepruar sipas propozimeve dhe parashtresave të qytetarëve, për të drejtat dhe interesat e tyre ose ndonjë iniciativë me interes publik.

### 1.3| Agjencia e Zbulimit

Duke vështruar kontrollin e brendshëm të paraparë me Ligjin për Agjencinë e Zbulimit, është e dukshme se ligji aktual mbi AZ nuk ofron ndonjë drejtim për kontrollin e brendshëm, por vetëm paraqet shkeljet e mundshme të disiplinës së punës<sup>19</sup> pa shqyrtim të mëtejshëm të procedurave disiplinore.

Më herët, Ligji për Agjencinë e Zbulimit ka përfshirë dispozitë që i ka mundësuar Drejtorit të AZ të parashkruan: shkelje të rënda të disiplinës të punës për shkak të cilave i punësuar i pezullohet nga puna, kohëzgjatje të periudhës së pezullimit, si dhe raste kur kjo e drejtë nuk është ushtruar, por Gjykata Kushtetuese ka anuluar këtë dispozitë duke konsideruar *se ajo mund të shkakton arbitraritet dhe mundësi për trajtim jo të barabartë, kështu që kjo çështje duhet të rregullohet me Ligjin mbi AZ ose me Marrëveshje kolektive*<sup>20</sup>.

Sipas një të punësuar nga shërbimet e zbulimit, i intervistuar për këtë botim, Agjencia e Zbulimit ka një komision disiplinor që vepron mbi kërkesë për inicim të procedurës disiplinore. Një kërkesë e tillë mund të dorëzohet nga kryetarët e njësive organizative të Agjencisë së Zbulimit, ose nga drejtori i Agjencisë së Zbulimit. Puna e Komisionit Disiplinor mbështetet në *rregullat dhe rregulloret për kryerjen e procedurave disiplinore*<sup>21</sup>.

Posti i Inspektorit të Përgjithshëm nuk ekziston në Agjencinë e Zbulimit të Maqedonisë.

---

18 | Ligji për Veprim ndaj Parashtrësive dhe Propozimeve [Law on Acting upon Complaints and Suggestions] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 82/2008

19 | Ligji i Agjencisë për Zbulim [Law on the Intelligence Agency], Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 19/95 Neni 30

20 | Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 37/1988

21 | Intervistë me zyrtarë nga shërbimet e zbulimit në Maqedoni, zhvilluar më 10.07.2012



donisë, edhe pse ajo konsiderohet si një rregullim efektiv i kontrollit të brendshëm në shumicën e vendeve. Sipas të intervistuarit tonë, ky post ka ekzistuar deri në vitin 2000, por është anuluar për shkak të racionalizimit të mjeteve dhe burimeve<sup>22</sup>. Korniza ligjore që mbulon segmentin e kontrollit të brendshëm në kuadër të Agjencisë së Zbulimit është e pamjaftueshme dhe kërkon përfshirjen e parimeve të përbashkëta, të pranuar për kontroll dhe vëzhgim, sikur themelimi i postit të Inspektorit të Përgjithshëm që do të merr rolin qendror në kontrollin e brendshëm AZ.

## **2| Kapacitetet për zbatim dhe administrim**

### **2.1| Ministria e punëve të Brendshme**

Vështrimi i raporteve të huaja mbi këtë temë (ju lutemi shihni fusnotën nr. 24, 25 dhe 26) mbi përparimin e vendit dhe praktikave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përshtypja e parë është se ende ka shumë punë për të bërë në fushën e kontrollit të brendshëm.

Prania e policisë në jetën e përditshme dhe në një numër të konsiderueshëm në mbarë vendin ka rritur gjasat e shkeljes së të drejtave të njeriut. Mekanizmat e zmadhuar të llogaridhënies kanë kontribuar për shqyrtim më të thellë të punës së policisë. Pavarësisht angazhimit të zmadhuar të bashkësisë ndërkombëtare në punën e MPB, që solli rritjen e transparencës ndaj qytetarëve, efektshmëria e institucioneve vëzhguese nuk tregon doemos se MPB ka kryer detyrat jashtëzakonisht mirë në fushën e përmirësimit të transparencës dhe përgjegjshmërisë ndaj qytetarëve dhe institucioneve shtetërore<sup>23</sup>.

Raporti i Progresit i Komisionit të BE për Maqedoninë për vitin 2011<sup>24</sup> mbulon këtë

---

22 | Ibid

23 | Bogdanovski. Andreja: Kapitulli 5 – Maqedonia në Almanakun e Vëzhgimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Beograd, 2012, mund të gjeni edhe në: [http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)


24 | Progres Raporti i BE-së për Republikën e Maqedonisë për vitin 2011, Kapitulli 22



fushë duke thënë se SKBSP ka intensifikuar monitorimin e punës së policisë, por akoma nuk është shndërruar në një autoritet, plotësisht të pavarur nga policia me kompetenca për zbatim të hetimeve efektive. Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit, mbi Praktikata e të Drejtave të Njeriut për vitin 2011 për Maqedoninë<sup>25</sup>, shton se edhe pse ka pasur përmirësime në zhvillimin e hetimeve të brendshme dhe prokurori publik ka qenë aktiv, mosdëshkimi i policisë mbetet problem.

Figura 1. ilustron rritjen e vazhdueshme të numrit të veprimeve që SKBSP ka administruar prej vitit 2006. Ky trend ka arritur kulmin në vitin 2009, pas kësaj vërehet një

## Numri rasteve të përgjithshme



Grafik 1 – Të dhëna statistikore mbi numrin e përgjithshëm të rasteve

zvogëlim i numrit të procedurave. Faktikisht, SKBSP ka vepruar mbi 691 raste në 2006, por numri i rasteve në 2009 gati se është dyfishuar – 1355 raste. Në vitin 2011, SKBSP ka reaguuar në 1250 raste. Gjysma e parë e 2012 përsëri tregon rritje në numrin e rasteve të inspektuara – 758 krahasuar me 630 në gjysmën e parë të 2011. Numri i rritur i hetimeve është shenjë pozitive, SKBSP ka përforcuar punën dhe numër më i madh i qytetarëve vendosin të kërkojnë drejtësinë nëpërmjet këtij mekanizmi. Por, nga ana tjetër mund gjithashtu të jetë tregues i sjelljes së keqësuar të zyrtarëve të policisë. Raporti i Komitetit të Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT)<sup>26</sup> nga viti 2010, thekson se një numër i konsiderueshëm i njerëzve pretendojnë se janë keqtrajtuar nga zyrtarët e policisë, sidomos nga inspektorë civil të kriminalistikës por gjithashtu edhe nga anëtarët e njësisë së posaçme Alfa.

---

mund të gjeni edhe në [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2011/package/mk\\_report\\_2011\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_report_2011_en.pdf)

25 | Mund të gjeni edhe në <http://www.state.gov/documents/organization/186589.pdf>

26 | Mund të gjeni edhe në <http://www.cpt.coe.int/documents/mkd/2012-04-inf-eng.htm>

Veç kësaj, KPT vëren mungesë të pavarësisë strukturore të SKBSP dhe thekson se kjo çështje ka rëndësi të veçantë, në rastet kur akuzat e keqtrajtimit ose veprimet të pahijshëm ana e zyrtarëve të zbatimit të ligjit, janë kryer në kontekst të veprimeve të profilit të lartë.<sup>27</sup>

SKBSP ka zhvilluar praktikën e shpalljes së rregullt të raporteve mbi inspektimet e kryera në faqen e MPB. Raportet përmbajnë të dhëna të mjaftueshme dhe të detajuara, por ajo që mungon janë të dhënat e posaçme që i përkasin Byrosë për Siguri Publike dhe Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim.

Megjithëse se kanë mandat të qartë për të vepruar mbi shkelje të të punësuarve në kuadër të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim, të dhënat në dispozicion publik nuk tregojnë raste ku inspektime të tilla janë zhvilluar. Kjo shtrun pyetjen nëse vallë aspak nuk zhvillohen inspektime brenda DSKZ nëse SKBSP nuk është mjaft transparent për të paraqitur publikisht rezultatet e kontrollit. Duke marrë parasysh kompetencat që i janë dhënë DSKZ (përdorimin e masave të veçanta, armëve etj), sigurimi i kontrollit të duhur të brendshëm mbi këtë organ ka rëndësi thelbësore. Pengesë tjetër e kontrolleve të brendshme efektive, së paku kur bëhet fjalë për DSKZ, është fshehtësia e masave të posaçme hetimore (siç është përgjimi), që zvogëlon mundësinë e paraqitjes së parashtrësive nga qytetarët për përdorimin e tyre.

Duke analizuar raportet vjetore të SKBSP<sup>28</sup> kuptojmë se rreth 2/3 nga parregullsitë e treguara vijnë nga parashtrësat e qytetarëve dhe subjekteve juridike, kurse e treta tjetër bazohet në të dhëna nga punonjësit e MPB, gjetjet e tyre, mediet ose me urdhër të Ministrit.

---

27 | Raporti ka lidhje me operacionin “Stuhia e Shkretëtirës” prej 2007, ndonëse kishte dokumentacione mjekësore dhe qarkullim i gjerë i dëshmimeve në fotografi për lëndime që tregojnë keqtrajtimin e personave të arrestuar, SKBSP raportoi që “ka kryer hetim të plotë në lidhje me operacionin, andaj është vlerësuar se ka qenë e planifikuar në mënyrë profesionale, e zbatuar njësoj dhe qëllimet për të cilën ishte planifikuar janë arritur dhe forca dhe armët e zjarrit janë përdorur në përputhje me dispozitat ligjore”.

28 | Raporti Vjetor i SKBSP për 2011, 2010 dhe 2009, mund të gjeni edhe në: <http://www.mvr.gov.mk/DesktopDefault.aspx?tabindex=0&tabid=201>



	Numri i përgjithshëm i parashtrësive	Me bazë	Pa bazë	Mungesë e provave	Pjesërisht me bazë
Viti 2007	61	9	33	19	/
Viti 2008	64	4	36	24	/
Viti 2009	79	6	37	36	/
Viti 2010	64	5	38	20	1
Viti 2011	63	8	44	11	/

Tabela 1<sup>29</sup> Parashtrësia nga tereni tek SKBSP, në bazë të dyshimit për përdorim të tepruar të forcës

Nëse krahasojmë grafikun 1 dhe tabelën 1, shihet qartë se përdorimi i tepërt i forcës nuk përfaqësohet me përqindje të lartë, në rastet e të përgjithshme. Lëviz mes pesë dhe gjashtë përqind. Diçka që lehtë vërehet, është fakti se shumica e parashtrësive të paraqitura në SKBSP janë kualifikuar si të pabazuara ose ju mungojnë prova. Numri i parashtrësive të bazuara është i papërfillshëm. Nga këto fakte lindin shumë pyetje shtesë, sikur, me cila sfida ballafaqohet SKBSP gjatë hetimeve të rasteve të paraqitura, ose nëse qytetarët janë të informuar siç duhet mbi kompetencat e SKBSP? Nëse ky trend vazhdon, kjo mund të shkakton zvogëlim në nivelin e besimit të qytetarëve në SKBSP dhe rrjedhimisht, në numrin e parashtrësive të paraqitura.

## Masat e domosdoshme të imponuara

SKBSP ka paraqitur 19 procedura penale për 30 të punësuar në MPB në vitin 2011. Në vitin 2010 numri i procedurave penale ka qenë 27 dhe në vitin 2009 SKBSP ka dorëzuar 36 procedura penale. Derisa numri i procedurave penale ka tendencë të uljes, numri i procedurave disiplinore është në rritje: 201 në 2009, 219 në 2010 dhe 228 në vitin 2011.

29 | Raporti Vjetor i SKBSP për 2011 mund të gjeni edhe në: <http://www.mvr.gov.mk/ShowAnnouncements.aspx?ItemID=10937&mid=1094&tabId=201&tabindex=0>

Asnjë prej procedurave penale në periudhën 2009-2011 nuk kanë qenë kundër punonjësve të Drejtorisë për siguri dhe kundërzbulimin<sup>30</sup>.

Viti	Numri i përgjithshëm i rasteve	Procedura penale të nisura	Procedura disiplinore të nisura	Paralajmërimet	Procedura me kom-pensim	Suspendim nga vendi i punës	Kërkesë për shkarkim pa procedurë para-prake disiplinore
2007	974	106	179	149	3	84	
2008	1148	75	173	122	32	39	
2009	1355	50	201	193	84	28	66
2010	1261	29	219	161	85	9	14
2011	1250	30	228	230	62	9	29

Tabela 2<sup>31</sup>- Masat e domosdoshme të imponuara nga SKBSP

SKBSP vetëm nis procedurat disiplinore dhe roli i tij përfundon këtu. Pastaj, procedura disiplinore vazhdon përpara Komisionit Disiplinor, i formuar nga Ministri. Kjo është shënuar edhe në Raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2011 për Maqedoninë<sup>32</sup>, ku thuhet se SKBSP ka autoritet vetëm të vendosë sanksione administrative gjatë zhvillimit të hetimeve të tija, dhe për këtë arsye nuk mund të detyron sanksione disiplinore (sikur shkarkim ose ricaktim në një post më të ulët), që kërkojnë vendim nga një komision disiplinor, ose sanksione më të rënda penale për shkelje më të rënda, kur ka prova të një veprë penale që kërkon veprim të gjykatës. Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) gjithashtu pranoi se SKBSP nuk kishte asnjë ndikim sa i përket sanksioneve disiplinore, të cilat mbetën në duart e prorëve të policit në fjalë.<sup>33</sup>

30 | Të dhëna të marra me qasjen e lirë të informatave

31 | Burim: Raporti Vjetor i SKBSP për 2011

32 | Mund të gjeni edhe në <http://www.state.gov/documents/organization/186589.pdf>

33 | Këshilli i Komitetit Evropian për Parandalimin të Torturës, raporti i vizitës së shtetit në vitin 2010 Mund të gjeni edhe në: <http://www.cpt.coe.int/documents/mkd/2012-04-inf-eng.pdf>



Efektshmëria e SKBSP është kritikuar edhe nga Avokati i Popullit në raportin e tij vjetor për 2011, i cili deklaroi se *vërehen mangësi në punën e Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale, në procedurat ndaj zyrtarëve të policisë për shkelje të lirive dhe të drejtave duke tejkuluar autorizimet zyrtare*<sup>34</sup>. Në të njëjtin raport vjetor, Avokati i Popullit thekson nevojën për profesionalizëm në punën e SKBSP.

Sa i përket kapacitetit administrativ, në vitin 2011 SKBSP ka krijuar një strukturë të re organizative. Prej fillimit të vitit 2011, SKBSP përbëhet prej pesë departamenteve, në vend të tre<sup>35</sup>. Është bërë një ndarje mes pjesës proaktive dhe reaktive. Ose më saktë, ndarje mes punëve parandaluese ndaj eliminimit të kushteve me ndikim në sjelljen joprofesionale të zyrtarëve të policisë, dhe ushtrimit të aktiviteteve për sigurim të provave për parregullsitë e paraqitura<sup>36</sup>. Gjithashtu ka parashikuar rritjen e numrit të anëtarëve të personelit prej 40 në 60, por nuk ka asnjë të dhënë nëse kjo është realizuar. Megjithatë, Raporti i Departamenti Amerikan të Shtetit për vitin 2011, konstaton se *fondet e pamjaftueshme dhe stafi kanë penguar efektivitetin e SKBSP, dhe se kapaciteti profesional i SKBSP ka mbetur i ulët*<sup>37</sup>.

SKBSP kryesisht forcon kapacitetet e veta përmes ndihmës së donatorëve të huaj. Një shembull i tillë mund të vërehet kur Programi për Asistencë Ndërkombëtare në Trajnim për Hetime Penale (ANTHP)<sup>38</sup> ka dhuruar pajisje të sofistikuara hetimore që duhet të përmirësojnë kapacitetet e SKBSP për t'u marrë me raste më të ndërlikuara. Veç kësaj, punonjësit e SKBSP rregullisht marrin pjesë në trajnime ndërkombëtare, seminare dhe vizita studimore<sup>39</sup>.

---

34 | Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2011, Shkup, Mars 2012 Mund të gjeni edhe në:

<http://www.ombudsman.mk/ombudsman/upload/documents/2012/Izvestaj%202011-ANG.pdf>

35 | Raporti Vjetor i SKBSP për 2011, Mund të gjeni edhe në <http://moi.gov.mk/ShowAnnouncements.aspx?ItemID=10937&mid=1094&tabid=201&tabindex=0>

36 | Ibid

37 | Mund të gjeni edhe në <http://www.state.gov/documents/organization/186589.pdf>

38 | ANTHP është program i Departamentit të Drejtësisë të Shtetit Amerikan që punon me shtete të huaja.

39 | Të dhëna të marra me qasjen e lirë të informatave

## 2.2| Ministria e Mbrojtjes

Nga të dhënat e përftuara me përdorimin e Aktit për Liri të të Dhënave, Ministria e Mbrojtjes ka krijuar dy organe përgjegjëse për kontroll të brendshëm<sup>40</sup>. I pari është Sektori për Inspektim në Mbrojtje, i përbërë nga një Departament të veçantë për inspektim në Mbrojtjen Civile. Në kuadër të këtij departamenti, ka një Këshilltar-Inspektor të ngarkuar me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe qytetarëve: Avokati i Popullit. Në vitet e fundit kurrë nuk ka pasur rast në lidhje me shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut, ose aktivitete të paligjshme gjatë punës së Ministrisë<sup>41</sup>. Veç kësaj, kurrë nuk janë nisur procedura disiplinore, kundërvajtje ose procedura penale ndaj punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes.<sup>42</sup>

MM identifikon këtë rezultat si pasojë e profesionalizmit të punës së tyre<sup>43</sup>. Puna e organeve të jashtme vëzhguese, si Avokati i Popullit, kur bëhet fjalë për Forcat e Armatosura është e kufizuar, kështu që shumë pak informacion është shpalosur mbi trajtimin aktual të personelit të Forcave të Armatosura. Sidoqoftë, habit fakti se Ministria e Mbrojtjes ka krijuar një Avokat të Popullit për mbrojtje, kur nuk ka informata publike në dispozicion për atë post.

Inspektori për të drejtat e të punësuarve dhe Avokati i Popullit të qytetarëve, janë përgjegjës dhe i përgjigjen Shefit të Njësisë për inspektim në mbrojtjen civile.

---

40 | Të dhëna të marra me qasjen e lirë të informatave

41 | *Ibid.*

42 | *Ibid.*

43 | *Ibid.*



Lloji i inspektimit		Numri i përgjithshëm i inspektimeve 2008-2011
I rregullt	Sipas Programit Vjetor të paraparë nga Ministri i Mbrojtjes	36
I jashtëzakonshëm	Kërkesë nga Ministri, institucioni shtetëror ose individual për shkak të dyshimit për parregullsi	11
Kontrollues	Kontrollim nëse parregullsitë e paraqitura janë shqyrtuar	2
Gjithsej		49

Tabela 3<sup>44</sup>

Siç u tha më parë, MM është e detyruar të publikon raporte tremujore të inspektimeve të kryera. Ministria ka filluar publikimin e raporteve të tilla në janar 2012, dhe ka dy raporte të tilla në dispozicion në internet. Raportet janë të pamjaftueshme, sa i përket të dhënave, mungojnë të dhëna themelore sikur rezultati i inspektimeve. Raportet përbëhen vetëm nga emri i institucionit ku janë kryer inspektimet.

Përveç inspektimit dhe Këshilltarit-Inspektorit për të drejtat e të punësuarve dhe qytetarëve, ministri i Mbrojtjes ka emëruar një person përgjegjës për të vepruar sipas parashtrësave dhe propozimeve të qytetarëve<sup>45</sup>, Këshilltari për veprim sipas parashtrësave dhe propozimeve të të punësuarve brenda sektorit për mbështetje të ministrit. Por në faqen e internetit të Ministrisë nuk ka asnjë informacion se një post i tillë ekziston, dhe as informata konkrete mbi personin e punësuar për të përmbushur këtë mandat. Prej vitit 2009, e deri në gjysmën e parë të vitit 2012, këshilltari ka vepruar mbi 130 parashtrësra dhe propozime të qytetarëve, por nuk ka në dispozicion asnjë informatë mbi rezultatin e këtyre parashtrësave dhe propozimeve. Sipas MM, të gjithë qytetarët në fjalë

44 | Tabela është formuar në bazë të të dhënave të marra me qasjen e lirë të informatave.

45 | Një obligim që vije nga Ligji për Veprim mbi Parashtrësat dhe Sugjerimet



kanë pranuar përgjigje<sup>46</sup>. Megjithatë, nuk ka asnjë informacion në lidhje me përqindjen e parashtrësve dhe përqindjen e propozimeve që dalin nga numri i përgjithshëm i paraqitjeve.

Megjithatë, nuk mund të anashkalohej fakti se është e çuditshme që ka dy institucione të ndryshme në krye të mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, që vetëm mund të habisin qytetarët që duan të paraqesin parashtrësë, propozim ose ndonjë problem.

Kur bëhet fjalë për zbulimin ushtarak dhe kundërzbulimin, kjo njësi është në vartësi të drejtpërdrejtë nga Ministri i Mbrojtjes, dhe në vitet e fundit kurrë nuk ka pasur rast që ka vënë në pah shkelje të ligjeve dhe të drejtave të njeriut, ose nuk është nisur procedurë disiplinore ndaj të punësuarve të njësisë së zbulimit ushtarak<sup>47</sup>. Në 3 vitet e fundit, asnjë inspektim nuk është kryer në zbulimin ushtarak dhe njësinë e kundërzbulimit.<sup>48</sup>

## 2.3| Agjencia e Zbulimit

Një nga dobësitë më të mëdha të identifikuara në mekanizmat e kontrollit të brendshëm në kuadër të Agjencisë së Zbulimit, është mosekzistimi i postit të Inspektorit të Përgjithshëm. Për shkak të kufizimeve buxhetore ky pozicion është anuluar. Ky shpjegim shkon kundër praktikave më të mira të themeluara në të gjithë Ballkanin Perëndimor, si dhe në Evropën Perëndimore, ku një pozitë e tillë konsiderohet si rol qendror në sigurimin e ligjshmërisë së punës së Agjencisë të Zbulimit.

Ky funksion është zëvendësuar nga Komisioni Disiplinor. Si duket, Drejtori i Agjencisë së Zbulimit ka përfshirë një pjesë të praktikave të kontrollit të brendshëm edhe në portofolin e tij/saj. Pavarësia e plotë e organeve të kontrollit të brendshëm nuk është siguruar, kjo varet nga profili i kreut të Agjencisë së Zbulimit, dhe për këtë shkak ndodhin pro-

---

46 | Të dhëna të marra me qasjen e lirë të informatave

47 | *Ibid.*

48 | *Ibid.*



cedura të caktuara tendencioze<sup>49</sup>. Përvoja e deritanishme tregon se, sa herë që shkelja e procedurave të të punësuarve të AZ është regjistruar, pjesa dërmuese e dënimeve kanë qenë gjoba financiare, por ka pasur edhe raste të shkarkimit nga Agjencia e Zbulimit. Mungesa e Inspektorit të Përgjithshëm reflektohet në sistemin e parashtresave brenda AZ. Nëse i punësuar dëshiron të paraqet një ankesë në lidhje me vendimin e Komisionit Disiplinor, ajo duhet të kalon përmes Drejtorit të AZ. Një alternativë e kësaj, do ishin gjykatat.

Është e qartë se fondet e siguruara nga Buxheti nuk mjaftojnë për të përmbushur nevojat e Agjencisë së Zbulimit, dhe kjo ka implikime të rëndësishme në mekanizmin kontrollues. Megjithatë, në vend që të rritet, nga viti në vit buxheti i Agjencisë së Zbulimit zvogëlohet.<sup>50</sup>

Një skandal lidhur me sjelljen e të punësuarve ndodhi në vitin 2008, kur një i punësuar i brendshëm sikur zbuloi<sup>51</sup> identitetin e agjentëve dhe dobësitë e tyre, sjelljet e pamoralshme dhe histori pikante nga vendi i punës, kur ai/ajo dërgoi një letër anonime në disa adresa, përfshirë edhe atë të drejtorit të Agjencisë së Zbulimit. Qëndrimi zyrtar i Agjencisë së Zbulimit ishte se pretendimet në letër nuk janë të vërteta.<sup>52</sup> Kjo deklaratë e shkurtër nuk ofron asnjë informacion në lidhje me nivelin e hetimit që është zhvilluar dhe nëse ka pasur pasoja të caktuara për të punësuarit. Në lidhje me këtë temë, vlen të përmendet se AZ nuk ka Zyrtar për Marrëdhënie Publike.

Sa i përket kapaciteteve administrative, të organeve të kontrollit të brendshëm të Agjencisë së Zbulimit, ka një pasqyrë që profesionistët e trajnuar për detyra të këtij portofoli të punës janë të punësuar<sup>53</sup>, por për shkak të mungesës së informacionit në dispozicion publik, asnjë informacion konkret rreth burimeve njerëzore mund të sigurohet.

---

49 | Intervistë me zyrtarë nga shërbimet e zbulimit në Maqedoni, zhvilluar më 10.07.2012.

50 | Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitet 2012,2011,2010 dhe 2009, mund të gjeni edhe në <http://www.finance.gov.mk/view/budget2012>

51 | Zbulohen agjentët sekret të Maqedonisë (Macedonian sec ret agents revealed), Vecer 27.02.2008 mund të gjeni edhe në: <http://www.vecer.com.mk/?ItemID=5A857525894E3F48800B99EE29496B1F>

52 | Ibid.

53 | Intervistë me zyrtarë nga shërbimet e zbulimit në Maqedoni, zhvilluar më 10.07.2012.

### 3| Vlerat

Trendi i vërejtur i rritjes së numrit të parashtresave tek SKBSP, kur bëhet fjalë për policinë, mund të tregon një rritje në nivelin e besimit dhe njohjes mes qytetarëve, se SKBSP është duke bërë punën e duhur, por në anën tjetër të medaljes, kjo mund të jetë edhe një regjistrim negativ për profesionalizmin e zyrtarëve të policisë. Shqetësimi më i madh është se vetëm disa nga parashtresat e dorëzuara tek SKBSP janë vlerësuar si me bazë.

Vlerësimi kritik i raporteve të huaja në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut në Maqedoni, së bashku me thirrjet e shpeshuara për përkushtim më të madh të vëmendjes për kontrollin e aktorëve të sektorit të sigurisë (sidomos policinë) kanë vënë kontrollin e brendshëm përsëri në qendër të vëmendjes të diskursit publik.

Shembulli më i fundit, i cili ngjalli debate dhe protesta në rrugët e Shkupit, është i lidhur me vrasjen e një studenti 24 vjeçar nga Shkupi, nga një zyrtar i njësisë speciale të policisë “Alfa” gjatë festimit pas zgjedhjeve. Kjo ka rezultuar në një rritje të thirrjeve për shpërbërje të njësisë Alpha dhe ka vënë në pikëpyetje profesionalizmin e SKBSP. Në të njëjtën kohë MPB është kritikuar për mungesën e transparencës dhe komunikimit me publikun.

Lëvizja e shoqërisë civile “Stop dhunës policore” inicioi propozim për krijimin e një autoritetit të pavarur, që do të merr përsipër kompetencat e SKBSP në fushën e parashtresave civile dhe peticioneve për shkelje të të drejtave dhe lirive të qytetarit nga zyrtarët e policisë në aksionet policore. Propozimi u pranua nga ana e partive opozitare, dhe pas kësaj ata dorëzuan në Parlament një propozim-ligj për Avokat Policor të Popullit, që duhej të merr kompetenca dhe përgjegjësi të veçanta në zbatimin e hetimit, ato raste kur haset në brutalitet të policisë ndaj qytetarëve<sup>54</sup>. Megjithatë, propozim-ligji nuk u pranua.

---

54 | Propozim ligji për Ombudsmanin Policor ishte parashtruar nga një grup i 42 deputetëve, mund të gjeni edhe në [https://docs.google.com/file/d/1Oqj1\\_oGhEGxdu2361fDrRkT9qXBcDMzLoTU81xRX-em\\_eDAR-1FBizYlctIWQ/edit?pli=1](https://docs.google.com/file/d/1Oqj1_oGhEGxdu2361fDrRkT9qXBcDMzLoTU81xRX-em_eDAR-1FBizYlctIWQ/edit?pli=1)



*Kah gjenerata e 2-të e*

## **Reformave në Sektorin e Sigurisë në MAQEDONI**

Duke marr parasysh faktin se MM nuk promovon publikisht mundësinë e paraqitjes së parashtrësës nga qytetarët dhe nuk është transparente sa duhet mbi kontrollin e brendshëm, mund të nxirret përfundimi se këto çështje nuk kanë prioritet për Ministrinë e Mbrojtjes. E njëjta gjë vlen edhe për Agjencinë e Zbulimit, që ka larguar edhe trupin bazë të kontrollit të brendshëm, Inspektorin e Përgjithshëm.

## 4| Rekomandime:

- Ligji mbi Agjencinë e Zbulimit duhet të ndryshohet për të përfshirë edhe parimet demokratike të kontrollit të brendshëm dhe të ri-themelon postin e inspektorit të përgjithshëm, përgjegjës për kontrollin e brendshëm dhe standardet profesionale.
- SKBSP duhet t'i jepet leje për t'u përfshirë në gjithë procesin e procedurave disiplinore si dhe në rezultatet e tyre përfundimtare.
- MM duhet të përmirësojë transparencën mbi inspektimet e kryera duke shpallur raporte të hollësishme.
- Veç kësaj, ajo duhet të promovojë dhe të njoh publikun me mundësitë e qytetarëve për të paraqitur parashtrësat dhe propozimet mbi punën e Ministrisë së Mbrojtjes.



## Kontrolli buxhetor

### Përmbledhje ekzekutive

Zbatimi i suksesshëm i konceptit për Kontroll të Brendshëm Financiar Publik është një vegël e rëndësishme për të siguruar që financat publike harxhohen në mënyrë efikase dhe të drejtë. Kështu, koncepti që shtrihet është zhvilluar nga Komisioni Evropian dhe është një prej tre komponentëve të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian mbi kontrollin financiar (ky është grupuar në Kapitullin 32, gjatë negociatave për zgjerim me Kroacinë)<sup>55</sup>. Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik përfshin tre komponentë: 1) menaxhimi financiar dhe kontrolli, 2) revizioni i brendshëm dhe 3) njësia qendrore për harmonizim. Megjithëse njësitë për çështje financiare dhe njësitë për revizion të brendshëm themelohen në kuadër të çdo entiteti publik, njësia qendrore për harmonizim është departament i veçantë në kuadër të Ministrisë së Financave, që shërben si pika qendrore për koordinim dhe komunikim. Deri më tani, gjitha përpjekjet janë përqendruar në miratimin dhe përmirësimin e kornizës ligjore, andaj ky proces është përfunduar dhe gjitha aktet nënligjore që shoqërojnë Ligjin për kontroll financiar janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi. Në nivelin qendror, jo gjithë entitet e sektorit publik kanë themeluar institucionet e përcaktuara në Ligjin për Kontroll të Brendshëm Financiar Publik - njësinë për çështje financiare, njësinë e brendshme të revizionit me person përgjegjës për informimin mbi parregullsitë. Mirëpo, kur bëhet fjalë për aktorët e sektorit të sigurisë (Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia për Zbulimit) ata kanë plotësuar kërkesat e ligjit. Megjithatë, kapacitetet administrative

---

55 | Përveç KBFP, dy komponentët tjerë janë: revizioni i jashtëm dhe mbrojtja e interesave financiare të BE-së.

mbeten të dobëta, veçanërisht brenda njësave të revizionit të brendshëm. Zhvillimi i mëtutjeshëm duhet të përqendrohet në legjislaturën dhe zbatimin e saj më të mirë në praktikë dhe të ngrihet niveli i vetëdijes për rolin dhe rëndësinë e kontrollit të brendshëm financiar publik.

## 1| Legjislatura

Shtylla kryesore e kontrollit të brendshëm buxhetor të marrësve të buxhetit shtetëror (përfshirë edhe institucionet e sigurisë – Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia për Zbulim) sigurohet me prezantimin e Sistemit për Kontroll të Brendshëm Financiar Publik. Zanafillat e sistemit mund të gjenden që prej vitit 2000<sup>56</sup>, por përpjekje të zakonshme për ngritjen e sistemit për kontroll të brendshëm në sektorin publik kanë filluar me miratimin e Ligjit për Kontrollin Financiar të Brendshëm Publik<sup>57</sup> në 2009. Ky sistem duhet të garantojë *shpenzimin e matur të financave publike*<sup>58</sup> si dhe respektimin e plotë të ligjit gjatë punës së përditshme. Parimi kryesor për arritje në këto qëllime, është zbatimi i parimeve të përgjegjësisë së decentralizuar të menaxhmentit dhe themelimi i revizionit të pavarur të brendshëm. Dispozitat ligjore që rrjedhin nga Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik vlejné për gjithë entitetet e sektorit publik<sup>59</sup> dhe janë financuar nga buxheti i shtetit përfshirë edhe fonde të BE-së.

Kontrolli Financiar i Brendshëm Publik (KBFP) përbëhet nga:

1. Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
2. Revizioni i brendshëm
3. Harmonizimi i kontrollit të brendshëm dhe revizionit të brendshëm

---

56 | Ministria e Financave, <http://www.finance.gov.mk/node/92>

57 | Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik [Law on Public Internal Financial Control] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 09/09

58 | Ministria e Financave, mund të gjeni edhe në: <http://www.finance.gov.mk/node/864>

59 | Me termin “entitet të sektorit publik” që ligji përcakton: nënkuptim përdoruesit e financave të Buxhetit të vendit, financat e komunave dhe qytetit të Shkupit, agjenci dhe institucione tjera të themeluara me ligj, ndërmarrje publike, institucione publike dhe entitete tjera ligjore që janë në pronësi të shtetit ose që shteti është aksionar.



Megjithëse rregullia e shpenzimeve ka qenë në qendër të sistemeve të brendshme tradicionale, KBFP sjell standarde më të larta, duke kushtuar më tepër vëmendje “vlerës së parave”, që nënkupton se jo vetëm kujdes që financat publike mos të keqpërdoren, por gjithashtu sigurim që të shpenzohet në mënyrën më ekonomike, efikase dhe efektive. Duke e ditur që KBFP është koncept relativisht i ri, procesi për sigurimin e një kornize relevante ligjore është kompletuar, përfshirë edhe legjislaturën sekondare, që përbëhen nga një shumë e akteve nënligjore dhe standardeve që janë miratuar dhe që kanë hyrë në fuqi. Korniza ligjore që rregullon KBFP është vlerësuar nga Mbështetja për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimit - SIGMA<sup>60</sup> si koherente, e plotë dhe në pajtim me kërkesat ligjore të Bashkimit Evropian<sup>61</sup>.

## 1.1| Menaxhim Financiar dhe Kontroll (MFK)

Shtresa e parë e kontrollit të brendshëm financiar sigurohet me “Menaxhim Financiar dhe Kontroll: mekanizmin që përfshin ***një sistem të politikave, procedurave dhe aktiviteteve të caktuara nga kreu i entitetit publik për të ofruar siguri të mjaftueshme që objektivat e entitetit janë plotësuar***<sup>62</sup>. Ndonëse nuk thekson saktësisht cilat janë ato objektiva, Ligji për kontroll të brendshëm financiar publik më vonë përshkruan që Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli siguron nëse entiteti publik:

- Zhvillon aktivitetet financiare në mënyrë të drejtë, etike, ekonomike, efektive dhe efikase
- Siguron përmbushje të operimeve me ligje, rregullore tjera, themelon politika, plane dhe procedura<sup>63</sup>.

---

60 | SIGMA është iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim OECD dhe Bashkimi Evropian, kryesisht e financuar nga BE-ja

61 | SIGMA Raporti i Vlerësimit mbi Maqedonisë, maj 2010

62 | Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik [Law on Public Internal Financial Control] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 09/09 Neni 3 paragrafi 3

63 | Ibid. Neni 6



Aktorët e sektorit të sigurisë (Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia për Zbulim), si entitete të sektorit publik kanë për detyrë të themelojnë njësi të veçanta për çështje financiare, kreu i të cilëve drejtpërdrejtë përgjigjet para Ministrit dhe Sekretarit të Shtetit.<sup>64</sup> Më tutje, aktorët e sektorit të sigurisë kanë për obligim të caktojnë person përgjegjës për parregullsi. Ministria e Financave ka përgatitur Doracak për menaxhim Financiar dhe Kontroll<sup>65</sup> si udhëzim për entitetet e sektorit publik për themelimin e sistemit për menaxhim financiar dhe kontroll dhe zbatimin e drejtë të detyrave.<sup>66</sup>

## 1.2| Revizioni i brendshëm

Qëllimi i revizionit të brendshëm është i ngjashëm me atë të sistemit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll – që është sigurimi i përdorimit të ligjshëm dhe të drejtë të financave publike duke identifikuar zbrazëtira dhe shkelje të mundshme në procedurat ligjore. Ndonëse sistemi për Menaxhim Financiar dhe Kontroll vazhdimisht vëzhgon procedurat dhe proceset e entiteteve publike, revizioni i brendshëm zhvillohet periodikisht. Ajo jep rekomandime për menaxhim financiar dhe kontroll, dhe kontribuon në përmirësimin e saj të vazhdueshëm, por pa mos poseduar kompetenca për imponimin e sanksioneve. Ministria e Financave ka hartuar një Doracak për Revizion të Brendshëm<sup>67</sup> dhe përdorimi i tij është i detyrueshëm për gjithë revizorët kur zhvillojnë revizione brenda entiteteve.

Pas vitit 2004, revizion i brendshëm u ndryshua prej formës së centralizuar në Ministrinë e Financave në model të decentralizuar me idenë e themelimit të njërive për revizion të brendshëm në secilin entitet publik.

---

64 | Ibid. Neni 9

65 | Mund të gjeni edhe në [http://www.finance.gov.mk/files/u10/PRIRACNIK\\_FMC30012012.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/PRIRACNIK_FMC30012012.pdf)

66 | Për objektivat kryesore të MFK dhe ingerencat e saja kryesore, shikoni Shtojcën 2

67 | Mund të gjeni edhe në <http://www.finance.gov.mk/node/972>



Në mesin e institucioneve të sigurisë, ligji nuk përmend posaçërisht Agjencinë për Zbulim prej entiteteve që duhet të themelohë njësi për revizion të brendshëm. Mirëpo, sipas ligjit, njësitë e revizionit të brendshëm duhet të themelohen në gjitha entitetet e sektorit publik që buxheti i tyre gjatë tre viteve të fundit ka arritur shumën prej 50 000 000 MKD (819 774 Euro). Nëse e marrim faktin që buxheti i Agjencisë për Zbulim për 2011 ka qenë 144 821 000 (2 354 813 Euro)<sup>68</sup> është e qartë se detyra për themelimin e njësisë për revizion të brendshëm duhet zbatuar. Nuk është e qartë përse Agjencia e Zbulimit nuk merr pjesë në listën, bashkërisht me institucionet tjera shtetërore si Ministria e Mbrojtjes.

Ligjvënësit sigurojnë që të ofrojnë (së paku në letër) pavarësi të njërive për revizion të brendshëm nga shtypjet politike. Këto njësi të veçanta organizative, janë të pavarura nga njësitë tjera të brendshme të entiteti dhe drejtpërdrejtë përgjigjen para Ministrit. Sipas kësaj, kreu i njësisë për revizion të brendshëm bashkë me revizorët tjerë nuk mund të pushohen nga puna ose të caktohen në post tjetër për raportimin e parregullive specifike. Gjithashtu, Ministri i Brendshëm ose Ministri i Mbrojtjes nuk kanë lirinë për të ndëshkuar sanksione disiplinore, ndrysim të postit ose pushim nga puna të punësuarve të njësisë për revizion të brendshëm me fuqinë e tyre, por njëherë kanë për obligim të njoftojnë Departamentin për Kontroll të Brendshëm Financiar Publik në kuadër të Ministrisë për Financa, dhe të ofrojnë dokumentimin e duhur që justifikon vendimin e marrë.

Nëse zbulohen parregullsi serioze ose dyshime për mashtrim ose korrupsion, revizori i brendshëm informon kreun e njësisë për revizion të brendshëm i cili ka për detyrë të parashtojë informata me shkrim Ministrit dhe personit përgjegjës për raportimin mbi parregullsitë<sup>69</sup>.

---

68 | Buxheti i Republikës së Maqedonisë [http://www.finance.gov.mk/files/Budzet\\_na\\_RM\\_za-2011\\_god\\_ZA%20OBJAVUVANJE\\_13.12.2010.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/Budzet_na_RM_za-2011_god_ZA%20OBJAVUVANJE_13.12.2010.pdf)

69 | Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik [Law on Public Internal Financial Control] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 09/09 Neni 50, paragrafi 4

### 1.3| Harmonizimi i kontrollit të brendshëm dhe revizionit të brendshëm – Departamenti për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (Departamenti KBFP)

Një departament i posaçëm për kontroll të brendshëm është themeluar në kuadër të Ministrisë për Financa dhe shërben si njësi qendrore harmonizimi për operacionalizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik dhe vëzhgimin e zbatimit. Ky ofron rekomandime për përmirësimin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Përveç kësaj, Departamenti i KBFP ka mandatin për të zhvilluar vëzhgimin e cilësisë së menaxhimit financiar dhe sistemeve kontrolluese dhe punën e njëjësive të revizionit të brendshëm, por deri më tani nuk ka bërë asnjë detyrë të tillë<sup>70</sup>, ndonëse është *sine qua non* për përmirësimin e zbatimit të kontrollit të brendshëm financiar dhe zbulimin e pengesave që ndikojnë mbi funksionimin e drejtë të sistemit.

Përveç Departamenti i KBFP, Ministria e Financave ka themeluar edhe dy komitete si organe konsultimi në sajë të Ministrisë, njëra për çështje lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe tjetra për çështje revizioni. Të dy komitetet kanë për obligim të takohen së paku njëherë në tre muaj<sup>71</sup> për të shkëmbyer informata dhe këshillime për Ministrin e Financave.

Ndonëse struktura duket e ndërlikuar, ajo është një model i BE-së që ishte zhvilluar nga Komisioni Evropian që vazhdimisht inkurajon shtetet që dëshirojnë të bashkohen Bashkimit Evropian të zhvillojnë *sisteme bashkëkohor të kontrollit të brendshëm publik*<sup>72</sup>. Ndonëse kontrolli i brendshëm financiar publik në fillim ka qenë si *aquis* “e butë” (pa legjislaturë specifike nga BE-ja), *Institucionet Evropiane (Këshilli, Parlamenti, Gjykata e Revizionit dhe Komisionit) kanë rënë dakord që në këtë Kapitull*<sup>73</sup>, shtetet kandidate

70 | Intervistë me zyrtarë nga sektori publik, zhvilluar më 17.07.2012

71 | Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik [Law on Public Internal Financial Control] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 09/09 Nenet 44 dhe 45

72 | Robert de Koning, Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik, mund të gjeni edhe në <http://www.pifc.eu/pdf/intro.pdf>

73 | Kapitulli 32 i Acquis communautaire



*duhet të reformojnë kontrollin e brendshëm publik dhe sistemet e jashtme revizore në mënyrë që ndjek dhe zbaton standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BE-së<sup>74</sup>.*

## 2| Praktika

Ministria e Financave (duke qenë institucioni lidhës përgjegjës për vendosjen e strukturave të reja dhe vëzhgimin e progresit) ka themeluar një Doracak për Revizion të Brendshëm dhe Doracak për Menaxhim dhe Kontroll Financiar që formojnë udhëzues për sqarimin e teknikave që përdoren gjatë zhvillimit të aktiviteteve të përditshme dhe ofrojnë pasqyrë të parimeve kryesore të kontrollit financiar publik<sup>75</sup>. Përveç kësaj, siç përcaktohet në Nenin 13, paragrafi 1 – Ligji për KBFP, Standarde për Kontroll të Brendshëm në Sektorin Publik<sup>76</sup> janë publikuar, si standarde ndërkombëtare të njohura për kontrollin e brendshëm. Doracakët dhe rregulloret e hartuara nga Departamenti i KBFP në kuadër të Ministrisë për Financa përdoren nga përdoruesit e buxhetit<sup>77</sup> që tregojnë se Departamenti ka hartuar legjislaturë praktike dhe të vlefshme që është e dobishme për gjithë përdoruesit.

Të gjithë aktorët e lidhur me sigurinë (Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia për Zbulim) kanë marrë iniciativat e duhura për themelimin e njësisë organizative dhe caktimin e posteve që parashikohen me Ligjin e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Të gjithë këta kanë themeluar njësi për çështje financiare, njësi për revizion të brendshëm dhe kanë caktuar një person përgjegjës për informimin mbi parregullsitë. Ata rregullisht plotësojnë obligimin për të dorëzuar raporte vjetore të re-

---

74 | Ibid.

75 | Doracakun për Revizion të Brendshëm dhe Doracakun për Menaxhim Financiar dhe Kontroll si dhe ligjet dhe aktet nënligjore tjera në lidhje me KBFP mund të gjeni në <http://www.finance.gov.mk/node/679>

76 | Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 147/11, mund të gjeni edhe në [http://www.finance.gov.mk/files/u10/ernal\\_control\\_standards\\_in\\_the\\_public\\_sector.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/ernal_control_standards_in_the_public_sector.pdf)

77 | SIGMA Raporti i Vlerësimit mbi Maqedonisë, maj 2011

vizioneve të zhvilluara nga Departamenti i KBFP, në kuadër të Ministrisë për Financa<sup>78</sup>.

Gjatë viteve të para pasi që ishte prezantuar ligji, ky mekanizëm hasi në vështirësi në plotësimin e kushteve që rrjedhin nga ligji. Vetëm disa entitete të sektorëve publik kanë themeluar njësi për çështje financiare, njësi për revizion të brendshëm dhe kanë caktuar një person përgjegjës për informimin mbi parregullsitë. Për shkak të vonesave në zbatim, Komiteti për Menaxhim Financiar dhe Kontroll dhe Komiteti për Revizion, si organe konsultimi të Ministrit, janë themeluar në gusht 2011, dy vite pas miratimit të ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar. Në maj 2012, janë përpiluar rregulloret për punën e tyre.

Sipas Progres Raportit të Komisionit për Maqedoninë, për vitin 2011, raportohet për përparim në fushën e kontrollit të brendshëm financiar publik, por kryesisht ka lidhje me përputhjen e ligjeve ndërsa zbatimi mbetet në nivel të ulët.<sup>79</sup> Ministria e Financave ka zhvilluar propozim strategji për periudhën 2012 – 2014 si plan afatmesëm për zhvillimin e DSKZ. Ajo përmban analiza të plota të situatave aktuale dhe rekomandon masa për përmirësime, por qëllimet afatgjate dhe planet e veprimit mungojnë. Përveç kësaj, ndonëse ishte zhvillua propozim strategjia në nëntor 2011 dhe vlen për periudhën 2012, versioni final i strategjisë ende nuk është publikuar.<sup>80</sup>

Propozim strategjia përbëhet nga një analizë të zbrazëtirës me mangësitë në DSKZ<sup>81</sup>:

- vetëdija për menaxhim financiar edhe përgjegjësia nëpër institucione është në nivel të ulët
- përdorim i pamjaftueshëm i resurseve revizore
- mungesë e njohurisë dhe përvojës për funksionet tjera të revizionit (performancë dhe TI revizion)

---

78 | Intervistë me zyrtarë nga sektori publik, zhvilluar më 17.07.2012

79 | Progres raporti i BE-së 2011 për Maqedoninë, Kapitulli 32: Kontrolli financiar, faqe 78

80 | Prej shtator 2012

81 | Propozim strategjia për zhvillimin e KBFP [Draft-Strategy for development of PIFC] (2012-2014)  
[http://www.finance.gov.mk/files/u10/Strategy\\_for\\_PIFC\\_MKD\\_proposal\\_Final.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/Strategy_for_PIFC_MKD_proposal_Final.pdf)



- procedura për ofrimin e revizionit cilësor nuk zbatohen
- korniza ligjore nuk zbatohet në tërësi

Në bazë të analizës së zbrazëtirës, strategjia gjithashtu paraqet edhe objektivat dhe rekomandimet si të arrihen, megjithatë, duhet të propozohen veprime më konkrete dhe kornizë kohore.

Sa i përket buxhetimit, entitetet e sektorit publik vendosin theksin në kontrollin mbi shpenzimet në vend të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të fondeve. Raportet që institucionet i dorëzojnë para Departamentit të KBFP japin kryesisht informata sasiore dhe me cilësi të dobët<sup>82</sup>.

Një mangësi tjetër që rrezikon zbatimin e plotë të LKBFP është certifikimi i revizorëve të brendshëm. Asnjë testim për të certifikuar revizorët e brendshëm nuk është zhvilluar deri më tani, që nënkupton se revizorët aktual nuk kanë certifikimin e duhur që do të dëshmojë profesionalizmin e tyre dhe t'ju jep autoritet dhe reputacion në sytë e të punësuarve në entitetin ku zhvillohet revizioni i brendshëm. Nuk është qartë përse kjo shtyhet, por përgatitjet për një testim të tillë kanë filluar pak para me fillimin e projektit "Trajnimi i revizorëve të brendshëm në sektorin publik"<sup>83</sup> dhe publikimi i shpalljes publike për trajnerë. Për fazën e parë, planifikohet që 40 revizorë të trajnohen për të arritur certifikimin ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i revizionit të brendshëm është të ofrojë rekomandime për tejkalimin e mangësive në menaxhimin financiar, një zyrtar i sektorit publik që ishte intervistuar për qëllime të këtij publikimi pohon se përqindja e rekomandimeve të miratuara në sektorin e sigurisë është në nivelin e duhur<sup>84</sup>.

---

82 | Propozim strategjia për zhvillimin e KBFP [Draft- Strategy for development of PIFC] (2012-2014) page 13, [http://www.finance.gov.mk/files/u10/Strategy\\_for\\_PIFC\\_MKD\\_proposal\\_Final.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/Strategy_for_PIFC_MKD_proposal_Final.pdf)

83 | Projekti është lansuar në verë 2012, në bashkëpunim me Qendër për Ekselencë në Financa QEF me seli në Lubjanë dhe Instituti për Financa Publike dhe Kontabël CIPFA me seli në Londër

84 | Intervistë me zyrtarë nga sektori publik, zhvilluar më 17.07.2012

### 3| Kapaciteti administrativ

Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik, si koncept relativisht i ri, kërkon investim të dukshëm në themelimin dhe pajisjen e nëpunësve shtetëror me shkathtësitë dhe njohuritë e duhura. Qeveria ka miratuar plane veprimi për realizimin e Programit Kombëtar për Miratimin e Acquis Communautaire (PKMAC) për 2009 (mes prioriteteve tjera) që synon edhe rritjen e kapaciteteve njerëzore të përfshirë në sistemin e KBFP-së. Në saj të gjitha sektorëve publik, Qeveria planifikon punësimin e 144 personave në njësitë e revizionit të brendshëm dhe 130 persona në njësitë e çështjeve financiare. Asnjëri prej këtyre punësimeve nuk ka qenë për institucionet e sektorit të sigurisë (MPB, MM dhe AZ). Sipas këtij Planit të Veprimit, këto institucione nuk kanë mungesë të të punësuarve në njësitë e tyre financiare, andaj nuk janë shpallur vende të reja pune. Sipas Planit të Veprimit<sup>85</sup>, numri minimal i posteve në njësitë për çështje financiare brenda MPB ishte 39, MM kishte 48 ndërsa Agjencia e Zbulimit vetëm 6. Duhet të përmendet që MPB dhe MM janë ministritë kryesuese në kuptim të numrit të të punësuarve në njësitë për çështje financiare.

---

85 | Plan i veprimit për realizimin e NPAA për 130 punonjës të ri në njësitë e punëve financiare në kuadër të entiteteve në nivelin qendror, mund të gjeni edhe në [http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen\\_plan\\_fmc.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen_plan_fmc.pdf)



Tabela 1 (shihni më poshtë) tregon kapacitete e resurseve njerëzore të njësive për revizion të brendshëm në MPB, MM dhe AZ.

Emri i institucionit të sektorit publik	Numri i revizorëve të brendshëm në datën 28.05.2009	Punësimet e planifikuara 2009-2010	Punësimet e planifikuara 2011	Numri i plotë i punësimeve të planifikuara	Numri i planifikuar i revizorëve të brendshëm pas punësimeve	Numri i revizorëve të brendshëm prej korrik 2012
Ministria e Brendshme	3	2	0	2	5	3
Ministria e Mbrojtjes	2	2	1	3	5	7
Agjencia për Zbulim	1	1	0	1	2	0

Tabela 1<sup>86</sup> - Njësitë e Revizionit të Brendshëm

Vërehet qartë se Ministria e Mbrojtjes jo vetëm që ka arritur, por edhe ka tejkuluar numrin e planifikuar të revizorëve, një fakt që vendos këtë Ministri në grupin e ministrive me punësime më të mëdha në Njësinë e Revizionit të Brendshëm<sup>87</sup>. Megjithatë, Plani i Veprimt nga Qeveria është në kundërshtim me nevojat e MM sipas aktit për sistematizim të ministrisë<sup>88</sup> që përcakton më tepër vende pune në këtë sektor. Nga ky këndvështrim, mund të përfundojmë se Ministria e Mbrojtjes mbetet me staf të pamjaftueshëm.

Ndonëse janë planifikuar punësime në Ministrinë e Brendshme, ajo ende mbështetet vetëm në tre revizorë të brendshëm. Nëse kemi parasysh faktin që MPB është një prej

86 | Tabela është bazuar në tabelën: Plan i veprimt për realizimin e PKMAC për 144 punonjës të ri të revizionit të brendshëm në kuadër të entiteteve në nivelin qendror, mund të gjeni edhe në [http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen\\_plan\\_vr.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen_plan_vr.pdf)

87 | Vetëm Ministria e Financave ka më tepër revizorë të brendshëm— 8 (prej korrik 2012)

88 | Informata të fituara duke dërguar pyetësorë në Ministri sipas Ligjit për qasje të lirë në informata me karakter publik



entiteteve më të mëdha publike me strukturë të ndërlikuar organizative, tre revizorë nuk mjaftojnë për të zhvilluar revizion të brendshëm, të plotë dhe cilësor. Përveç kësaj, nëse krahasojmë buxhetet e MB, buxheti i MPB është pothuaj se dyfish.<sup>89</sup> Nevoja për më tepër punësime gjithashtu është theksuar edhe në Planin Strategjik të Njesisë për Revizion të Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme për periudhën 2009 deri 2011, në të cilën planifikohet numri i të punësuarve që plotëson nevojat e Ministrisë të jetë dy ekipe me pesë persona me kompetenca të ndryshme dhe drejtues<sup>90</sup>. Njëlloj sikur me rastin e MM, Plani i Veprimtimit nga Qeveria dhe Plani Strategjik i MPB nuk janë të harmonizuar.

Më brengosëse është situata brenda Agjencisë për Zbulim. Në fakt, në 2009, Agjencia për Zbulim kishte një revizor të brendshëm dhe sipas tabelës 1, Qeveria ka planifikuar punësimin e një personi tjetër. Mirëpo, nëse analizojmë listën e revizorëve publik të shpallur në ueb faqen e Ministrisë<sup>91</sup>, jo vetëm që nuk është caktuar revizor i brendshëm, por edhe revizori që ka qenë i pranishëm mungonte. Gjithsesi, sipas zyrtarëve të intervistuar nga shërbimet e zbulimit, organi për revizion ekziston.

Nga ana tjetër, departamenti i KBFP në kuadër të Ministrisë së Financave, resurset materiale-financiare dhe njerëzore mjaftojnë për të plotësuar nevojat për këtë departament si njësi qendrore harmonizimi.<sup>92</sup> Departamenti i KBFP në sajë të Ministrisë së Financave vazhdimisht organizon trajnime për gjithë punonjësit nga sektori publik përfshirë edhe sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik. Të punësuarit e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Brendshme duhet gjithashtu të marrin pjesë në këto trajnime. Duhet të përmendet që pjesa më e madhe e trajnimeve janë rezultat i ndihmës së donatorëve të huaj, ose më saktë, nën projektet MATRA<sup>93</sup> dhe TWINING<sup>94</sup>.

---

89 | Buxheti i MPB për 2011 – 10 056 979 000 MKD, Buxheti i MM për 2011 – 5 671 376 000 MKD [http://www.finance.gov.mk/files/Budzet\\_na\\_RM\\_za-2011\\_god\\_ZA%20OBJAVUVANJE\\_13.12.2010.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/Budzet_na_RM_za-2011_god_ZA%20OBJAVUVANJE_13.12.2010.pdf)

90 | Të dhëna të mbledhura me qasjen e lirë të informatave

91 | [http://www.finance.gov.mk/files/u16/ci\\_navnatresni\\_revizori-centralno-03-07-2012.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u16/ci_navnatresni_revizori-centralno-03-07-2012.pdf)

92 | Intervistë me zyrtarë nga sektori publik, zhvilluar më 17.07.2012

93 | MATRA – Përforsimi dhe zbatimi i kontrollit të brendshëm financiar publik në nivelin qendror (2009 – 2010), financuar nga Qeveria Holandeze.

94 | TWINING – "Përkrahja e procesit të decentralizimit fiskal me përforsimin e kapaciteteve për menaxhim të fortë financiar dhe kontroll të brendshëm financiar në nivelin lokal dhe qendror", financiarisht



## **4| Vlerat**

Në brendësinë, ka nivel të lartë të vetëdijes për themelimin e kontrollit të brendshëm publik financiar në mesin e gjitha partive politike dhe miratimi i Ligjit për Kontrollin e Brendshëm Publik Financiar ishte shoqëruar me disa amendamente konstruktive në Parlament. Megjithatë, kur bëhet fjalë për zbatimin e KBFP, duket qartë se kriteri i vetëm për nivelin e zbatimit është ekzistimi i veçorive që rrjedhin nga ligji dhe jo nga cilësia e punës së tyre. Mund të arrihet në konkluzion që qëllimi dhe përfitimet të cilat i ofron nuk kuptohen në tërësi nga entitet e sektorit publik. Ndonëse parimi kryesor i kontrollit të brendshëm publik financiar është përgjegjësia e decentralizuar e menaxhmentit, ingerenca e vendimmarrjes ende është e rezervuar për menaxhmentin kryesor dhe Ministrin.

---

mbështetur nga BE-ja dhe menaxhuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të Holandës.

## 5| Rekomandime:

- Departamenti i KBFP në kuadër të Ministrisë për Financa duhet të fillojë vëzhgimin e cilësisë së KBFP sistemit menjëherë.
- Ministri i Financave duhet të përpilojë një plan veprimi si dhe kornizë kohore për Strategjinë e KBFP. Përveç kësaj, Strategjia duhet të përfshijë edhe qëllime afatgjate.
- Kapacitetet e resurseve njerëzore në Zyrat e Revizionit të Brendshëm në sajë të Ministrisë së Brendshme dhe Agjencisë për Zbulim duhet të përforcohen duke punësuar staf plotësues.
- Procesi i certifikimit të revizorëve të brendshëm duhet të fillojë pa vonesë.



## Kontrolli parlamentar

### Përmbledhje ekzekutive<sup>95</sup>

Parlamenti maqedonas vazhdimisht kryen kontrollin themelor dhe vëzhgimin e institucioneve të sektorit të sigurisë. Megjithatë, zbrazëtirat aktuale legjislative dhe mungesa e vullnetit politik shpesh transformon parlamentin në një "agjenci qeveritare." Mungesa e materialeve, burimet financiare dhe administrative vazhdojnë të pengojnë procesin e vëzhgimit të plotë. Zbrazëtira të dukshme ekzistojnë kur bëhet fjalë për rolin e saj vëzhgues për shkëmbimin e të dhënave konfidenciale dhe tregtinë e armëve.

Nga pikëpamja e shpenzimeve buxhetore, Parlamenti bën një punë të drejtë të ushtrimit të kontrollit. Propozimet buxhetore dhe ligji final i buxhetit janë të analizuar nga komiteti përkatës parlamentar, si dhe në nivel plenar. Komiteti për Siguri dhe Mbrojtje tregon përparim të mirë gjatë diskutimit të implikimeve financiare, kur legjislacioni i ri i sigurisë është në rendin e ditës. Megjithatë, deputetët janë duke u përballur me kohë të vështira për të vëzhguar shpenzimet e shërbimeve të zbulimit.

Duke pasur parasysh rolin e parlamentit në vëzhgimin e përdorimit të masave të veçanta hetuese, mjetet detyruese dhe të drejtat e njeriut, ajo tenton të ofrojë vëzhgim të mirë. Një komitet i specializuar për vëzhgimin e punës së Agjencisë së Zbulimit dhe Njësisë për Siguri dhe kundërzbulim është në vend. Që nga viti 2008 ka pasur një komitet plotësues që merret me vëzhgimin e zbatimit të teknikave për komunikim-përgjim. Të dy komitetet kryesohen nga anëtarë të partisë opozitare që ju jep më shumë autonomi dhe rritje të aktiviteteve. Në praktikë, meqenëse, dy komitetet hasin në pengesa të vazhdueshme nga partitë në pushtet që i ushtrojnë në mënyra të ndryshme (ndryshime frekvente të anëtarëve të komitetit, votim i shpërndarë, etj.).

---

95 | Për më tepër informata mbi parlamentin, shikoni edhe Bogdanovski. Andreja: Kapitulli 5 – Maqedonia në Almanakun e Vëzhgimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Beograd, 2012, mund të gjeni edhe në: [http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)

Përveç rolit të tyre të votimit për të penguar pjesëmarrjen në operacionet e mbështetjes së paqes, Parlamentit i mungon vullneti politik për t'u bërë më i angazhuar në diskutimin e çështjeve në mënyrë aktive si implikime buxhetore, vendosmëria, ose mandatet. Sipas mendimit të deputetëve, pjesëmarrja në operacionet jashtë vendit është një parakusht për integrimin e suksesshëm në BE dhe NATO, diçka që një pjesë e konsiderueshme e popullsisë e identifikon si një prioritet.

## 1| Kontrolli dhe vëzhgimi

### 1.1| Kontrolli buxhetor

#### A| Legjislatura

Sipas Kushtetutës<sup>96</sup> (Neni 68) dhe Ligjit për Buxhet<sup>97</sup>, Parlamenti është përgjegjës për miratimin e buxhetit. Megjithatë, nuk mund të themi konkretisht se Parlamenti ka “fuqinë mbi qesen” sepse procedura përfshin shumë aktorë tjerë<sup>98</sup> dhe Parlamenti ka marrë rolin për të dhënë fjalën e fundit. Në fillim, propozimi i buxhetit diskutohet në nivel të komitetit dhe pastaj kalon në seancë plenare. Në mesin e 21 anëtarëve, Këshilli për Siguri dhe Mbrojtje (KSM) dhe Komiteti për Financa dhe Buxhet janë dy komitetet që konsultohen dhe shprehin mendime mbi propozimet buxhetore nga perspektiva e sigurisë<sup>99</sup>. Megjithatë, ka edhe tre komitete plotësuese që merren me tema lidhur me sigurinë dhe që nuk konsultohen me automatizëm:

---

96 | Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë. [Constitution of the Republic of Macedonia]. Neni 68

97 | Ligji për buxhete [Law on the Budget]. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr.64/05 Nenet 29 dhe 30

98 | Ministria e Financave përgatit propozime për buxhet sipas prioriteteve strategjike të Qeverisë dhe prioriteteve strategjike të përdoruesve. Pastaj, propozim buxheti dorëzohet Qeverisë dhe Qeveria e dorëzon para Parlamentit.

99 | Udhëzues për Buxhete (Budget guide) CRPM, mund të gjeni edhe në: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2012/03/VodicvobuzetiMKD.pdf>



- Komiteti për Vëzhgimin e Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim (në tekstin e mëtutjeshëm Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive për Zbulim);
- Komiteti për Vëzhgimin e Zbatimit të Teknikave për Përgjimin e Komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes (në tekstin e mëtutjeshëm Komiteti për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikimeve);
- Komiteti i Përhershëm Anketues për të Drejtat dhe Liritë e Qytetarit (në tekstin e mëtutjeshëm Komiteti Anketues).

Megjithatë, nëse bëhet një vështrim më të afërt në përbërjen e Komitetit të Prindërve<sup>100</sup> për çështje që lidhen me financat, Komiteti për Financa dhe Buxhet (KFB), gjithashtu përmban disa prej anëtarëve të komiteteve që merren me tema të ndryshme të sigurisë (të përmendura më lartë), diçka që ju jep atyre mundësinë për të ngritur pyetje të implikimeve të mundshme financiare mbi sektorin e sigurisë kur diskutojnë propozimin e buxhetit. Për më tepër, çdo anëtar i Parlamentit mund të kërkojë që të jetë i pranishëm në një takim të komitetit, të ndryshëm nga atij që i përket, por pa pasur të drejtë vote<sup>101</sup>. Megjithatë, kjo e drejtë ka qenë e përdorur vetëm në ad hoc baza.

Duke shikuar legjisllacionin që lidhet me miratimin e buxhetit (Ligji mbi Buxhetin dhe Rregullat dhe Procedurat e Parlamentit), shihet se aktorët e sektorit të sigurisë ose të sektorit të sigurisë në një kontekst më të gjerë nuk janë përmendur. Ligji për Mbrojtje, megjithatë, dhe në veçanti Neni 17 i cili përshkruan rolin e Parlamentit në çështjet që lidhen me mbrojtjen e vendit<sup>102</sup>, përcakton se Kuvendi vendos për nivelin e burimeve financiare për nevojat e mbrojtjes, si dhe që Parlamenti miraton buxhetin në gjendje

---

100 | Komitetet amë janë komitete kryesore brenda Parlamentit që veprojnë si pika qendrore për ndonjë temë të veçantë të diskutimit dhe koordinon komitetet tjera që janë lidhur ngushtë me atë temë të veçantë.

101 | Rregullorja e Kuvendit të RM-së [Rules and procedures of the Assembly] Neni 121

102 | Ligji për Mbrojtje – teksti i spastruar [Law on Defence – consolidated text] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 185/11 Neni 17, 2001

luftë. Përveç kësaj, kur bëhet fjalë për kontrollin mbi shpenzimet, Ligji për Mbrojtjen<sup>103</sup> e obligon Ministrinë e Mbrojtjes për të informuar Qeverinë si dhe Parlamentin në lidhje me realizimin e burimeve të miratuara financiare. Nga ana tjetër, ligjet që rregullojnë punën e Ministrisë së Brendshme dhe Agjencisë së Zbulimit nuk i referohen në mënyrë eksplicite kontrollit parlamentar mbi shpenzimet buxhetore.

Kur bëhet fjalë për planifikimin e buxhetit, komitetet nuk kanë kompetenca të qarta që duhet të përfshihen në fazat e planifikimit të buxhetit. Megjithatë, ata mund të ushtrojnë këtë në mënyrë indirekte njëjloj sikur procedura për paraqitjen e amendamente për projekt-buxhetin.

Edhe pse Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive për Zbulim nuk është përmendur në rregulloren e buxhetit të miratuar dhe në procesin e kontrollit të buxhetit, Ligjit për Agjencinë e Zbulimit<sup>104</sup> në Nenin 11 obligon Drejtorin e Agjencisë së Zbulimit që të mundëson qasje në të gjitha raportet dhe informatat nga puna e Agjencisë deri tek Komiteti Parlamentar, që kanë detyrë për të vëzhguar punën e AZ (në këtë rast do të jetë Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive për Zbulim). E njëjta vlen edhe për Drejtorinë për Siguri dhe Kundërzbulim<sup>105</sup>. Sërish, regjistrat në këtë drejtim janë të kufizuar dhe të paplotë.

## B| Praktika

Me fuqinë e Parlamentit për të thënë fjalën e fundit në procesin e miratimit të buxhetit, ai në fakt bën ex ante kontroll mbi planet e shpenzimeve të aktorëve të sigurisë dhe përqindja që ata marrin nga buxheti i përgjithshëm i shtetit. Nëse shikojmë historinë e kohës të fundit të punës së Komitetit për Buxhet dhe Financa, të dhënat tregojnë se ky komitet parlamentar nuk ka diskutuar drejtimin e legjislationit në të cilin është i orien-

---

103 | Ibid. Neni 147

104 | Ligji i Agjencisë për Zbulim [Law on the Intelligence Agency], Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 19/95

105 | Ligji për Punë të Brendshme [Law on Internal Affairs]. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 92/2009 Neni 42



tuar sektori i sigurisë<sup>106</sup>.

Përveç kësaj, pjesa e buxhetit të Republikës e përcaktuar për institucionet e sektorit të sigurisë është subjekt i debatit në nivel plenar. «Diskutimet shpesh bëhen më të animuar në seancat plenare kur shpalesen skandale mbi keqpërdorimin e supozuar të financave publike dhe krijohet një mundësi për opozitën që të fiton pikë politike. Sjellja e tillë mund të shpjegohet nga deputetët e opozitës meqë kanë pak pushtet në nivel të komitetit. Ato nuk mund të mbivotojnë deputetët e partisë në pushtet, të cilët nuk janë të interesuar të veprojnë pavarësisht dhe të kyçen në diskutime në të cilat kritikohet qeveria.»<sup>107</sup> Në seancat plenare, deputetët tentojnë të diskutojnë shpenzimet e MPB, përpjesëtimin e buxheteve të MPB dhe MB dhe keqpërdorimin e mundshëm të financave publike.

Kur konsiderohet fuqia e Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive për Zbulim për të kontrolluar shpenzimet e DSKZ dhe AZ, komiteti tregon cilësi të dobët. Në maj 2012, DSKZ ka dorëzuar raportin për vitin e kaluar 2011, por sipas komitetit, raporti i DSKZ nuk përmban informatat themelore financiare. ***Nuk është e qartë se ku dhe se si fondet e buxhetit janë shpenzuar, çfarë lloj të pajisjeve janë blerë, çfarë ishte procedura dhe nëse gjithçka ishte në përputhje me ligjin. Nuk është siguruar as raport financiar për buxhetin e të ashtuquajturit buxhet të veçantë të Drejtorisë***<sup>108</sup>. Veç gjithë këtyre, raporti i AZ ishte në përputhje të plotë me dispozitat ligjore dhe të gjitha informatat e nevojshme janë siguruar.<sup>109</sup>

Një nga diskutimet më të gjalla, kur bëhet fjalë për shpërndarjen e fondeve në sektorin e sigurisë u zhvillua në vitin 2008, kur buxheti i DSKZ ishte rritur për 32 herë apo më

---

106 | Procesverballi nga mbledhjet e komitetit, ueb faqja e Parlamentit, [www.sobranie.mk](http://www.sobranie.mk)

107 | Bogdanovski. Andreja: Kapitulli 5 – Maqedonia në Almanakun e Vëzhgimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Beograd, 2012, mund të gjeni edhe në: [http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)

108 | Што содржи извештајот на УБК до Парламентот? [What does the DSCI report for the Parliament consist?], Utrinski, 15.05.2012, available at: <http://www.utrinski.com.mk/?itemID=C42D9EC98F2D-814B8C8A07A833CC73EC>

109 | Hera e parë DSZ-ja dorëzon raport para deputetëve, Mijalkov nuk erdhi [DSCI submitted a report to the MPs for the first time, Mijalkov didn't come] 16.05.2012 mund të gjeni edhe në: <http://www.plusinfo.mk/vest/43127/Prvpat-UBK-dostavi-izveshtaj-do-pratenicite-Mijalkov-ne-dojde>



saktësisht shumën e 780 000 euro të planifikuara në fillim të vitit, me rebalancimin e buxhetit në korrik të njëjtit vit u kthye në 25 milionë euro, ndërsa fondet e Ministrisë së Mbrojtjes u ndërprejnë.<sup>110</sup>

Komiteti për Siguri dhe Mbrojtje, duke vepruar si komiteti amë për çështjet e sigurisë, nuk është fillimisht e interesuar për çështjet financiare të sektorit të sigurisë. Megjithatë, ka treguar një sërë diskutimesh për çështjet financiare të legjislaturës së propozuar ku parashikohen implikime financiare.

## **1.2. Kontrollimi i përputhjes së punës me ligjet dhe respektimi i të drejtave të njeriut**

### **A| Legjislatura**

Kur bëhet fjalë për përputhjen e punës me ligjet dhe respektimin e drejtave të njeriut, tre prej katër Komiteteve të përmendura më parë kanë kompetenca edhe në këtë fushë.

Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive të Zbulimit është themeluar për të vëzhguar metodat dhe mënyrat që përdoren nga ana e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencia për Zbulim gjatë zbatimit të masave të posaçme hetuese dhe mënyrave de-tyruese. Anëtarët e Komitetit kanë qasje të lirë në të dhënat e klasifikuara. Kushti për presidentin e komitetit është të jetë nga partia e opozitës me të cilën do të sigurohet pavarësi më e madhe.

Komiteti për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikimeve në ingerencat e saja ka edhe elemente të qarta që kanë të bëjnë me dimensionin e të drejtave të njeriut. Komiteti

---

110 | Kontrolli Sekret i Shërbimeve Sekrete [Secret control of the secret services] Dnevnik, 27.11.2011 mund të gjeni edhe në:

<http://www.dnevnik.com.mk/?itemID=BF99804621491D4F9EA4D53A97F6B2F5&arc=1>



shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me vëzhgimin e zbatimit të teknikave për përgjim nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Gjithashtu, shqyrton edhe ligjshmërinë e zbatimit të teknikave për përgjim nga Ministria për Punë të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes në kuptim të përputhjes së tyre me Ligjin e Përgjimit të Komunikimeve.<sup>111</sup> Ngjashëm me kolegët e tyre nga Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive të Zbulimit, anëtarët e Komitetit për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikimeve kanë qasje të lirë në gjitha të dhënat e klasifikuara dhe presidenti i komitetit gjithashtu është nga opozita. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e anëtarëve të këtij komiteti vijnë nga partia opozitare.

Ka një dallim të caktuar mes dy komiteteve të përmendura më lartë dhe Komiteti i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe Drejtave të Njeriut, veçanërisht në një aspekt të posaçëm. Zbulimet dhe konkluzionet e këtij komitetit mund të jenë bazë për fillimin e procedurës për përgjegjshmëri të zyrës publike - bartësit<sup>112</sup>. Përveç kësaj, Komiteti ka kompetenca për të shqyrtuar parashtrësia nga qytetarët dhe të merr qëndrim në lidhje me ata, të vëzhgojë zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që shteti ka ratifikuar dhe të përpunojnë temën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Mund gjithashtu të jep mendime dhe propozime në lidhje me zbatimin e dispozitave kushtetuese që rregullojnë të drejtat e njeriut.<sup>113</sup>

## **B| Praktika**

Komiteti për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikimeve është përballuar me vështirësi të mëdha për dhënien e lejes për sekrete të nivelit shtetëror për disa prej anëtarëve sepse procesi i verifikimit për disa prej anëtarëve ka zgjatur më shumë sesa është planifikuar, ndonëse Ligji për Informata të Klasifikuara përshkruan që procesi i verifikimit zgjat më

111 | Kuvendi i RM-së [Macedonian Parliament]. Mund të gjeni edhe në: <http://www.sobranie.mk/?ItemID=8608F9D2973DFD4EAB951DD13354E2C4>

112 | Ibid , mund të gjeni edhe në: <http://www.sobranie.mk/default-mk.asp?ItemID=B-029F595A44B0049BB0C38372A2CEF54>

113 | Ibid, mund të gjeni edhe në: <http://www.sobranie.mk/?ItemID=334C6DD00873D74D-802B2A1B79B2E437>

së shumti 6 muaj dhe mund të vazhdohet vetëm në raste më të ndërlikuara dhe të jashtëzakonshme.<sup>114</sup>

Kryetari i komiteti ka pohuar që Ministri i Punëve të Brendshme tenton të mbajë Komitetin më larg MPB dhe të pengojë punën e tyre të rregullt. Madje miratoi edhe konkluzionin që Parlamenti duhet të konsiderojë përgjegjësinë politike të Ministrin për Punë të Brendshme për shkak të degradimit dhe trajtimit të papërgjegjshëm të Komitetit për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikacionit, deputetëve dhe parlamentit si dhe për mosrespektimin e Ligjit për Përgjimin e Komunikimit<sup>115</sup>. Një prej arsyeve të interpelancës së Ministrin të Brendshëm në vitin 2012 ishte refuzimi i saj për të dhënë Komitetit qasje në objektet e MBP për të kontrolluar ligjshmërinë e përdorimit të masave hetuese “të përdorura” gjatë rastit “Fushatë”<sup>116</sup>. Ministri mohoi këto akuza, duke thënë se asnjëherë nuk ka përdorur teknikë përgjimi gjatë këtij rasti<sup>117</sup>. Interpelanca nuk ishte e suksesshme për shkak të mbështetjes së partive në pushtet të cilët gjithë votuan kundër.

Ndonëse Komiteti për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikimeve ka mandat për vëzhgimin mbi teknikat e përgjimit të përdorura nga MM, ajo asnjëherë nuk ka qenë lëndë e debatit gjatë mbledhjeve të komitetit. Një sqarim i mundshëm është se zbulimi ushtarak asnjëherë nuk ka qenë i përfshirë në ndonjë skandal dhe deputetët janë të mendimit se këto tema nuk janë në interes të publikut. Megjithatë, duhet të përmendet se anëtarët e komitetit kanë zhvilluar një mbledhje me Ministrin e Mbrojtjes dhe zyrtarë tjerë të lartë nga MB në korrik 2012<sup>118</sup>, por informatat që janë dhënë publikut kanë qenë

---

114 | Ligji për Informata të Klasifikuara [Law on classified information] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 9/04, Neni 57

115 | Komiteti për Vëzhgimin e Zbatimit të Masave për Përgjimi i MBP-së dhe MM-së kërkon përgjegjësi politike nga Jankuloska për rastin “Fushata” [Committee supervising communication interception is asking for political responsibility from Jankuloska for the case “Campaign”] MTV, mund të gjeni edhe në: [http://www.mtv.com.mk/mk/vesti/makedonija/34735/komisijata\\_za\\_nadzor\\_nad\\_sproveduvanje\\_na\\_merkite\\_za\\_sledenje\\_na\\_komunikacite\\_na\\_mvr\\_i\\_mo\\_baru\\_.aspx?utm\\_source=daily.mk](http://www.mtv.com.mk/mk/vesti/makedonija/34735/komisijata_za_nadzor_nad_sproveduvanje_na_merkite_za_sledenje_na_komunikacite_na_mvr_i_mo_baru_.aspx?utm_source=daily.mk)

116 | Rasti “Fushata” është rasti i arrestimit të Ljube Boskovski, lideri i partisë politike, i cili ishte dënuar dhe gjykuar me 7 vite burg për financim të paligjshëm të fushatës politike dhe abuzim të pozitës (pas zgjedhjeve në 2011). Përkrahësit dhe familjarët e z Boskovski pohojnë se ai ka qenë i arrestuar për shkaqe politike.

117 | 15th plenary session of the Parliament, conducted on 25.11.2011

118 | Besimi në takim me anëtarët e Komitetit për Vëzhgim mbi zbatimin e masave për ndjekje të



të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur informata themelore për çështjet e diskutuara.

Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive të Zbulimit gjithashtu përballohet me sfida gjatë zbatimit të funksionit të vëzhgimit. Ndonëse DSKZ dhe AZ kanë obligim ligjor për të dorëzuar raportet e tyre vjetore para komiteteve që në fillim të vitit<sup>119</sup>, institucionet jo çdoherë i respektojnë afatet. Për shembull, AZ dhe DSKZ kanë dorëzuar raportet e tyre vjetore për 2009 në vitin 2010. Përveç raporteve të vonuara, Komiteti për Vëzhgimin e Agjencive të Zbulimit asnjëherë nuk e ka hasur programin vjetor të DSKZ për vitin 2012<sup>120</sup>. Dhe, Drejtori i DSKZ asnjëherë nuk ka qenë i pranishëm në seanca të komitetit dhe zakonisht dërgon zyrtarë tjerë nga drejtoria. Gjithashtu, presidenti i këtij komiteti theksoi se i kishin premtuar një CD me shqyrtime të hollësishme për përdorimin e masave speciale hetuese do të dorëzohet komitetit, por ajo ende nuk ka ndodhur<sup>121</sup>.

Komiteti i Përhershëm Anketues për të Drejtat dhe Liritë e Qytetarit zakonisht mbledhet për të diskutuar raportet vendore dhe të huaja nga institucionet përkatëse<sup>122</sup> në fushën e të drejtave të njeriut, por edhe legjislaturën që merret me të drejtat e njeriut dhe liritë. Nëse shikohet historiku i punës së tyre, vërehet qartë se ky komitet ka ulur frekuencën e mbledhjeve dhe ka pasur vetëm një gjatë nëntë muajve të vitit 2012. Komiteti Anketues ka luajtur rolin e tij kur diskutohej për rastin “Sopot” (2009-2010) dhe ka themeluar një grup pune për të shqyrtuar rastin. Në rastin “Sopot”, 11 persona janë akuzuar

---

komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes (Besimi had meeting with members from Committee supervising communication interception) , mund të gjeni edhe në: <http://www.mia.mk/default.aspx?mld=31&vld=95952239&lld=1&title=%D0%9C%D0%90%D0%9A%D0%95%D0%94%D0%9E%D0%9D%D0%98%D0%88%D0%90+-+%D0%9E%D0%94%D0%91%D0%A0%D0%90%D0%9D%D0%90+-+%D0%98+-+%D0%91%D0%95%D0%97%D0%91%D0%95%D0%94%D0%9D%D0%9E%D0%A1%D0%A2>

119 | Ligji për Punë të Brendshme (O.G.92/09) përcakton që DSKZ-ja duhet të dorëzojë program vjetor në janar dhe raportin për vitin e ardhshëm në shkurt.

120 | Afati për dorëzimin e raportit vjetor është janar për vitin aktual

121 | Çfarë përmban raporti i DSZ-së në Parlament? [What does the DSCI report for the Parliament consist?], 15.05.2012, mund të gjeni edhe në: <http://www.utrinski.com.mk/?ItemID=C42D9EC98F2D-814B8C8A07A833CC73EC>

122 | Raporti i Avokatit të Popullit, drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, BE, raporti i SHBA-ve mbi të drejtat e njeriut

për terrorizëm dhe shpallur fajtorë kur dy ushtarë të NATO-s dhe një civil janë vrarë në një minë në fshatin Sopot në vitin 2003. Iniciativa për themelimin e grupit të punës ka ardhur nga familjarët e të dënuarve duke pohuar se ishin të pafajshëm. Përveç kësaj, dëshmitari kryesor që i tregoi këto persona si kriminel, më vonë deklaroi se ka dhënë dëshminë duke qenë i keqtrajtuar nga policia. Grupi i punës arriti në iniciojë përsëritje të gjykimit.

Për dallim nga rasti i Sopotit, Komiteti i Përhershëm Anketues për të Drejtat dhe Liritë e Qytetarit nuk ka bërë asnjë kontroll nëse autoritetet kanë përdorur procedura jashtëligjore në rastin e Khaled El-Masri, i cili ishte kapur nga policia kufitare duke e gabuar për një terrorist të dyshuar, që gjoja ishte mbajtur në një hotel në Shkup për tre javë dhe pastaj ishte transferuar në një burg të drejtuar nga CIA ku ishte keqtrajtuar<sup>123</sup>. El Masri filloi procedurë ligjore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Republikës së Maqedonisë.<sup>124</sup>

---

123 | Për më tepër informata lidhur me Khaled El Masri rastin, lexoni deklaratën e tij në: <http://www.aclu.org/human-rights-national-security/statement-khaled-el-masri>

124 | El-Masri v. Macedonia, Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut, aplikacioni nr. 39630/09 mund të gjeni edhe në: [http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{"fulltext":\["El Masri"\],"documentcollectionid":\["COMMITTEE","CLIN","ADVISORYOPINIONS","REPORTS","RESOLUTIONS"\],"itemid":\["001-110887"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/sites/eng/Pages/search.aspx#{)



## 1.3| Kontrolli dhe vëzhgimi i zbatimit të politikave qeveritare dhe ligjeve të miratuara nga Parlamenti

### A| Legjislatura

Sipas rregullave dhe procedurave, Parlamenti ka kompetenca në kontrollin politik dhe vëzhgimin e Qeverisë.<sup>125</sup> Ajo ka tre mekanizma për ushtrimin e kontrollit dhe vëzhgimit mbi zbatimin e politikave qeveritare dhe ligjeve: shqyrtimin e vëzhgimeve, interpelancat dhe pyetjet parlamentare.

Ligji mbi Parlamentin parashikon vetëm një mekanizëm kontrolli dhe ajo është duke bërë shqyrtimin e vëzhgimeve të zbatuara nga ana e Komiteteve për të marrë informacione në lidhje me themelimin dhe zbatimin e politikave, zbatimin e ligjeve dhe aktivitete tjera të Qeverisë dhe institucioneve shtetërore. Përfaqësuesit e autorizuar që ftohen kanë për obligim të jenë të pranishëm gjatë mbledhjeve në të cilat është caktuar shqyrtim i vëzhgimeve<sup>126</sup>. Presidenti i Komitetit fton përfaqësuesit e autorizuar dhe mund të kërkojë informata plotësuese, mendime dhe shqyrtime të dërgohet në formë të shkruar së paku tre ditë para se të zhvillohet mbledhja e caktuar.

Përveç shqyrtimit të vëzhgimeve, rregullat dhe procedurat e Parlamentit saktësisht zhvillojnë procedurën e interpelancës që mund të fillohet nga së paku 5 deputet. Akti i njëjtë përshkruan procedurën për pyetje parlamentare, sipas të cilës, çdo e enjte e muajit është rezervuar për seanca të pyetjeve parlamentare.

Parlamenti ka kompetenca të organizojë edhe debate publike para miratimit të legjislaturës, në të cilën ftohen ekspertë dhe palët e interesuara për të diskutuar ligjet e propozuara nga Qeveria.

---

125 | Rregullorja e Kuvendit të R. së Maqedonisë (version i konsoliduar) Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 130/210 Neni 213, mund të gjeni edhe në: <http://www.sobranie.mk/?ItemID=72D-87D12D74B454FA2C28948BD83AA44>

126 | Ligji për Kuvendin [Law on the Assembly of Republic of Macedonia], Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë 104/09 Neni 20

## B| Praktika

Komitetet e Parlamentit nuk e ushtrojnë ingerencën për të zhvilluar shqyrtimin e vëzhgimeve. Në korrik 2012, partia kryesore e opozitës kishte përgatitur një listë të seancave të ndryshme të shqyrtimit të vëzhgimeve prej të cilave dy prej shtatë janë lidhur me aktorët e sektorit të sigurisë: e para ka qenë fokusi në financat e DSKZ dhe e dyta keqpërdorimi i teknikave për përgjim nga ana e Ministrisë për Punë të Brendshme në rastin “Fushata”.<sup>127</sup>

Ndonëse shqyrtimet për vëzhgim nuk përdoren shpesh, Parlamenti ka iniciuar tre interpelanca për Ministrin e Punëve të Brendshme – në vitin 2009, 2010 dhe 2012, që e bën ministren një prej funksionarëve me më shumë interpelanca. Megjithatë, të gjitha ishin të pasuksesshme. Që prej kohës kur Maqedonia morri pavarësinë në vitin 1991, asnjë ministër nuk ka lëshuar funksionin për shkak të interpelancës. Deputetët nga partia në pushtet rregullisht tregojnë besim ndaj ministrave që janë nën interpelancë. Deputetët zakonisht i drejtojnë pyetjet e tyre parlamentare Ministrin të Brendshëm. Pyetjet më të rrepta zakonisht vijnë nga anëtarët e opozitës ndërsa anëtarët e partisë në pushtet zakonisht parashirojnë pyetje që do të krijojnë pamje të një vëzhgimi aktiv. Pyetjet parlamentare zakonisht ndërlihen me raste konkrete nga puna e MPB, por gjithashtu edhe pyetje më të gjera për politikën e MPB në përgjithësi, prioritetet dhe aktivitetet e ardhshme. Deputetët gjithashtu kanë pyetur Kryeministrin pyetje lidhur me çështjet e brendshme dhe punën e Ministrin të Punëve të Brendshme.

Kur bëhet fjalë për debate publike, komitetet e sigurisë nuk përdorin opsionin për të organizuar debate publike për legjislatoren e propozuar të sigurisë. Gjatë verës së 2012, Parlamenti ka zhvilluar tre debate publike për të diskutuar ligje relevante të sigurisë<sup>128</sup>, por iniciatori ka qenë Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian.

---

127 | Opozita e vendosur nëpërmjet Kuvendit të kontrollojë Qeverinë [Opposition determined to control the Government through the Parliament], Kapital, 05.07.2012, mund të gjeni edhe në: [http://www.kapital.mk/MK/makedonija/86076/opozicijata\\_reshena\\_preku\\_sobranieto\\_da\\_je\\_kontrolira\\_vladata.aspx](http://www.kapital.mk/MK/makedonija/86076/opozicijata_reshena_preku_sobranieto_da_je_kontrolira_vladata.aspx)

128 | Debate publike ishin mbajtur në temat: Ligji për ndryshimin e Ligjit për Përgjimin e Komunikimeve, Ligji për ndryshimin e Ligjit për Punë të Brendshme dhe Ligji për ndryshimin e Ligjit mbi Policinë



## 1.4| Kontrolli dhe vëzhgimi i bashkëpunimit dhe integritetit bilateral dhe multilaterale të sigurisë së vendit

### A| Legjislatura

Në kuptim të bashkëpunimit bilateral dhe multilateral, Parlamenti ka marrë rolin e ratifikuesit të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Qeveria ose nga Presidenti.<sup>129</sup> Ligji për Mbrojtje përcakton që Parlamenti të ratifikon marrëveshje ndërkombëtare që përfshijnë hyrjen, kalimin ose qëndrimin e forcave të armatosura të huaja në territorin e vendit për shkak të ushtrimit, stërvitjes ose pjesëmarrjes në aksione paqësore ose humanitare. Ky paragraf vlen edhe për misionet e forcave të armatosura të vendit. Megjithatë, kur Maqedonia do të hyjë në NATO, kjo fuqi e plotë vendimmarrëse do të kufizohet, që nënkupton se vetëm në rrethana të jashtëzakonshme Qeveria mund të vendos nëse të bashkëngjitet operimeve paqësore të kryesura nga NATO.<sup>130</sup>

Në fushën e shkëmbimit të të dhënave konfidenciale, Parlamenti ka kompetenca në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare kur bëhet fjalë për shkëmbimin e informatave të klasifikuara. Megjithatë, rolin qendror në këtë kuptim ka marrë Drejtoria për mbrojtjen e informatave të klasifikuara.

Çështjet në lidhje me tregtinë me armë diskutohen vetëm nga Qeveria. Vetëm njëherë Parlamenti ka zhvilluar debat të rreptë dhe ka marr imunitetin e deputetit Vlado Buçkovski kur është akuzuar për përfshirje në mashtrim dhe prokurim të paligjshëm të armëve gjatë ushtrimit të postit të ministrit të mbrojtjes<sup>131</sup>.

---

129 | Ligji për Mbrojtje – teksti i spastruar [Law on Defence – consolidated text] Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 185/11, neni 17

130 | Neni 41a, prezantuar me amendamentet e Ligjit për Mbrojtje nga viti 2006, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 58/06), neni 16

131 | Ju lutemi lexoni më tepër për këtë rast në: [http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en\\_GB/features/setimes/features/2007/08/21/feature-01](http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2007/08/21/feature-01)



## B| Praktika

Procesi i ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare si dhe dërgimi i trupave në operacione paqësore ka tendencë të bëhet formalitet mes deputeteve, si në nivelin e komiteteve, ashtu edhe në nivelin plenar. Ajo që mungon është një debat më i përhapur mes deputeteve në lidhje me këto aktivitete. Parimisht, me progresin e Maqedonisë drejtë BE dhe NATO, zhvillohet një besim që pjesëmarrja në operacione paqësore do të përforcojë gjasat për kyçje në këto organizata. Mungesa e vlerësimit të buxheteve të operacioneve paqësore mund të sqarohet nga fakti që shtetet tjera mbulojnë një pjesë të madhe të shpenzimeve të operacioneve<sup>132</sup>.

Ka një regjistër modest të ad hoc raporteve të kërkuara për operacionet me rrezik të lartë. Nga kjo, koha e vetme kur deputetët kanë kërkuar mbledhje të jashtëzakonshme të Komitetit ka qenë viti 2008, kur një helikopter nga pjesëmarrja e Maqedonisë në misionin ushtarak të BE-së në Bosnje e Hercegovinë u rrëzua dhe njëmbëdhjetë persona humbën jetën.<sup>133</sup>

Qytetarët e Maqedonisë e ndërlidhin kontributin në operacionet paqësore ndërkombëtare me prospektet e bashkimit në BE dhe NATO. Në vitin 2010, 73% të qytetarëve kanë vlerësuar rolin e armatës maqedonase në operacionet paqësore si pozitive, sipas një ankete që të zhvilluar nga Instituti për Demokraci "Societas Civilis". Në shtete tjera, përqindja e përkrahjes për operacionet paqësore jo çdoherë arrin mbi 50%.<sup>134</sup>

Në çdo vit, përveç atyre delegacioneve të Republikës së Maqedonisë që vizitojnë njësitë paqësore nga armata në Afganistan, është praktikë që dy anëtarë të Komisionit për Siguri dhe Mbrojtje të marrin pjesë në delegacione. Në këtë aspekt, komunikimi me

---

132 | Bogdanovski. Andreja: Kapitulli 5 – Maqedonia në Almanakun e Vëzhgimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Beograd, 2012, mund të gjeni edhe në: [http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)

133 | Ibid.

134 | Nova Makedonija (2010) Maqedonasit përkrahës më të mëdhenj të ushtrive të saja jashtë vendit [Macedonians the biggest supporters of their soldiers abroad], Nova Makedonija, mund të gjeni edhe në: <http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=517101026129&id=9&set-lzdanie=21985>



Ministrinë e Mbrojtjes duket të jetë i mirë, sepse çdoherë kur ka vizita nga përfaqësues të ministrisë, një anëtar i Komitetit i bashkëngjitet delegacionit<sup>135</sup>.

Përveç pjesëmarrjes në misionet paqësore, gjatë seancave të pyetjeve të deputetëve, ata kanë kërkuar bashkëpunim rajonal dhe nënshkrim të marrëveshjeve bilaterale nga Ministria e Punëve të Brendshme, por kjo zakonisht vjen nga anëtarët e partive në pushtet që dëshirojnë të theksojnë zhvillimet më të reja pozitive në planin rajonal.

Megjithatë, kjo praktikë është ndërprerë në shkurt 2012, kur partia shqiptare PDSH<sup>136</sup> ka reaguar rreptësisht kundër Ligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim policor mes Maqedonisë dhe Serbisë që mundëson ndjekje të policisë serbe në territorin e Maqedonisë (dhe anasjelltas), duke argumentuar që ishte e pakushtetueshme dhe kundër shqiptare<sup>137</sup>.

## **1| Kapaciteti administrativ**

Komitetet parlamentare nuk posedojnë shkathtësitë e nevojshme për vëzhgimin e përmirësuar të institucioneve nga sektori i sigurisë. Vëzhgimi financiar mbi shpenzimin e buxhetit në fusha si siguria dhe mbrojtja kombëtare mund ndonjëherë të jetë tepër teknik dhe specifik (p.sh. kur bëhet fjalë për prokurimin e armëve, etj) por mund të jetë edhe një teme e kufizuar ku aktorët e sektorit të sigurisë nuk kanë vullnet për të shpalosur numrin e saktë dhe shifrat para vëzhguesve. Nëse e kemi këtë parasysh, atëherë pritet nga Parlamenti të sigurojë shërbime përkatëse për mbështetje (në kuptim të ekspertizës) dhe trajnim të deputeteve për të përmirësuar rolin e tyre të vëzhgimit.

Meqë është Komiteti kryesor, KSM përbëhet nga gjithsej 12 anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Ndonëse pjesa më e madhe e tyre nuk kanë përvojë paraprake dhe njohuri në

---

135 | Të dhëna të mbledhura duke përdorur qasjen e lirë në informata

136 | Partia Demokratike Shqiptare

137 | Thaçi: Maqedonia dhe Serbia bashkëpunojnë në dëm të Shqiptarëve [Tachi: Macedonia and Serbia cooperate against the Albanians], Dnevnik, 22.02.2012 mund të gjeni edhe në <http://dnevnik.mk/default.asp?ItemID=F9CDC90C7622C24FBB60A181FD70EC73>

fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duket të ketë përzjerje nga prapavija të ndryshme arsimore që ofrojnë bazë për debate të qëndrueshme në temë. Kryetari i Komitetit, nga ana tjetër, theksoi që njohuria dhe ekspertiza në punën e Komitetit është në nivelin e duhur dhe që angazhimi i stafit plotësues mund të kushtojë shumë.<sup>138</sup>

Komiteti për vëzhgimin e agjencive të zbulimit përbëhet nga presidenti, tetë anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Asnjëri prej anëtarëve të saj kanë përvojë relevante arsimore në çështje të lidhura me sigurinë. Duhet të përmendet që tre deputetë janë jurist të diplomuar.

Në këtë kontekst, Komiteti për Vëzhgimin e Përgjimeve të Komunikimit përbëhet nga presidenti, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Kapaciteti i tyre administrativ është i mjaftueshëm, duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e tyre kanë të mbaruar shkollimin e juridikut dhe një anëtarë ka magjistraturë në teknologji informatike dhe komunikacion. Në raportin vjetor për 2011 mbi punën e Komitetit për Vëzhgimin e Përgjimeve të Komunikimit që kanë dorëzuar Parlamentit, anëtarët e Komitetit kanë theksuar që do të kërkojnë mbështetjen e një ekspertit të jashtëm dhe bashkëpunim me trupat parlamentare nga vendet tjera.<sup>139</sup> Komiteti për Vëzhgimin e Përgjimeve të Komunikimit ka bashkëpunuar me sektorin joqeveritar, duke ftuar ekspertë të jashtëm të diskutojnë dhe shkëmbejnë mendimet e tyre në mbledhjet e Komitetit. Për shembull, dy profesorë universitar kanë qenë të pranishëm në mbledhjen e Komitetit dhe kanë marrë pjesë në diskutimin kur propozim ligji për ndryshimin e Ligjit për Përgjimin e Komunikimeve ishte në rend të ditës<sup>140</sup>.

Këto Komitete nuk kanë buxhet të veçantë dhe anëtarët për mbështetjen e stafit ofrojnë ekspertizë plotësuese për deputetët (përveç nevojave administrative). Sipas nenit 20 të Ligjit për Parlamentin, si përmirësim të legjislaturës së saj, vëzhgim dhe kapacitet

---

138 | Intervistë me Vladimir Gjorcev – kryetar i Komitetit për Siguri dhe Mbrojtje, e zhvilluar më 23 korrik 2010.

139 | Deputetët do të kërkojnë kolegë me përvojë jashtë shtetit për vëzhgim të përgjimit [MPs will ask experienced colleagues from abroad to help them with the oversight over communication interception] Kanal 5, 31.01.2012 mund të gjeni edhe në: [http://kanal5.com.mk/default.aspx-?mld=37&egld=13&eventId=86389](http://kanal5.com.mk/default.aspx?mld=37&egld=13&eventId=86389)

140 | Dr.Vladimir Pivovarov dhe Dr. Frosina Remenski ishin të pranishëm në mbledhjen e 9-të të Komitetit për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikimit, e zhvilluar më 18.07.2012



analitik-hulumtues, Parlamenti do të themelojë një njësi të veçantë organizative – Institut Hulumtues Parlamentar. Në të vërtetë, në vitin 2010 Parlamenti filloi të punojë në themelimin e burimit të pavarur të njohurive dhe ekspertizës. Projekti ishte financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AZZB) me përkrahje plotësuese të USAID dhe instituteve parlamentare të Sllovakisë dhe Republikës Çeke. Ndonëse ky projekt ishte paralajmëruar dhe procesi i punësimit kishte filluar, AZZB vendosi të anulojë projektin<sup>141</sup>.

## 2| Vlerat

Mungon vullneti politik për kryerjen e kontrollit parlamentar dhe vëzhgimin mbi sektorin e sigurisë. Deputetët e parlamentit që i takojnë partisë në pushtet (pavarësisht nga periudha), druajnë se angazhimi ose qasja e tyre aktive në vënien në pikëpyetje të punës së zyrtarëve publik, vetëm do t'ju rrezikon anëtarësinë partiake ose edhe ardhmërinë e tyre. Vet fakti që parlamenti kurrë nuk ka votuar kundër ndonjë anëtari të qeverisë, tregon qartë se, pasi deputetët të zgjedhin qeverinë, ata ju japin përkrahje të gjerë për shkak të besnikërisë partiake.

Një sondazh i zhvilluar nga Instituti për Demokraci, në bashkëpunim me Westminister Fondacionin për Demokraci, qartë tregon këndvështrimin e qytetarëve mbi këtë çështje. Pyetjes së parashtruar, mbi nivelin e kontrollit që parlamenti e ka mbi qeverinë, 45,7 % janë përgjigjur se kontrolli është i dobët, 32,1% se është i përshtatshëm dhe vetëm 10 % besojnë se parlamenti ka kontroll të fortë mbi Qeverinë.<sup>142</sup>

---

141 | Nuk ka qëndrim zyrtar për anulimin e projektit nga AZZB, dhe as nga Parlamenti i Maqedonisë. Në janar 2012, AZZB-ja ka dërguar letër Sekretarit të Përgjithshëm të Parlamentit duke shprehur pakënaqësinë e tyre që shpallja për tre pozitat menaxhuese kanë qenë të kurdisura, ndonëse kandidatët kanë plotësuar kërkesat e nevojshme. Burimi: <http://www.vesti.alfa.mk/default.aspx?eventid=46004&mld=36&egld=6>

142 | Mendimi publik mbi punën e Parlamentit, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" & Westminister Foundation, janar 2012, <http://www.idscs.org.mk/images/stories/upload/anketi/prezentacija-sobranie-201201.pdf>

## 5| Rekomandime<sup>143</sup>:

- Kur partitë politike vendosin të caktojnë deputetë për anëtarë të Komiteteve, posaçërisht ata që merren me vëzhgimin e zbulimit, duhet të sigurojnë që deputetët të kenë interes të veçantë në fushën përkatëse dhe sipas mundësisë, edhe përvojë ligjore.
- Anëtarët e Komiteteve duhet të vizitojnë trajnime speciale, veçanërisht për vlerësimin e buxhetit; funksionimin e shërbimeve të zbulimit, operacioneve për mbështetje të paqes;
- Parlamenti duhet të angazhojë këshilltarë për të përkrahur Komitetin për Vëzhgimin e Përgjimit të Komunikacioneve, Komitetin për Mbrojtje dhe Siguri dhe Komitetin e Përhershëm për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut. Përveç kësaj, të gjitha këto katër entitete duhet të kenë të përcaktuar buxhetin e tyre. Komitetet që kanë për detyrë të ndjekin Agjencinë e Zbulimit, Drejtorinë për Siguri dhe Zbulim dhe Njësinë për Zbulim dhe Kundërzbulim të Ushtrisë në koordinim me ministrinë përkatëse dhe agjencitë (MPB, MB dhe Agjencia për Zbulim) duhet të zhvillojnë një plan vjetor për trajnim për të plotësuar zbrazëtirat e kompetencave të deputetëve. Komiteti për Mbrojtje dhe Siguri dhe Komitetet tjera relevante duhet të insistojnë në më shumë debate publike dhe diskutime për propozim ligjet.
- Duhet të themelohet një grup parlamentar i punës për të shqyrtuar raportet finale të Zyrës Shtetërore për Revizion.
- Komiteti për Mbrojtje dhe Siguri dhe Komitetet tjera relevante duhet të insistojnë në më shumë debate publike dhe diskutime për propozim ligjet, veçanërisht për ligjet sistematike (p.sh. polici, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia për Zbulim, etj).

---

143 | Shikoni edhe Bogdanovski. Andreja: Kapitulli 5 – Maqedonia në Almanakun e Vëzhgimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Beograd, 2012, mund të gjeni edhe në: [http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)



## Bibliografia:

### Burimet primare:

1. Ligji për Punë të Brendshme [Law on Internal Affairs]. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 92/2009

Ligji mbi Punët e Brendshme është ndryshuar: 12.03.2010 (O.G. nr.35/10), 23.03.2011 (O.G. nr. 36/11) 15.11.2011 (O.G. nr. 158/11) dhe 14.09.2012 (O.G. nr.114/12)

2. Ligji i Agjencisë për Zbulim [Law on the Intelligence Agency], *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 19/95

3. Ligji për Mbrojtje – teksti i spastruar [Law on Defence – consolidated text] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 185/11

4. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 52/91

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është ndryshuar me amendamentet më poshtë: Amendamenti I dhe II (10 janar 1992); Amendamenti III (02 korrik 1998); Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII (20 nëntor 2001); Amendamenti XIX (30 dhjetor 2003); Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX dhe XXX (09 dhjetor 2005)

5. Ligji për Kuvendin [Law on the Assembly of Republic of Macedonia], *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* 104/09

6. Ligji për Informata të Klasifikuara [Law on classified information] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 9/04

Ligji për Informata të Klasifikuara është ndryshuar: 20.09.2007 (O.G. nr.113/07), 05.11.2010 (O.G. nr.145/10) dhe 20.09.2007 (O.G. nr.113/07)

7. Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik [Law on Public Internal Financial Control] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, nr. 09/09
8. Rregullorja e Kuvendit të R. së Maqedonisë [Rules and procedures of the Assembly]
9. Rregullorja për Kryerjen e Punëve të SKBSP [Rules and regulations of SICPS]
10. Procedura Standarde dhe Procedura për kryerjen e vëzhgimit dhe kontrollit në polici [Standard procedures and practices for oversight and control of the Police]
11. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 37/1988
12. Propozim strategjia për zhvillimin e KBFP [Draft-Strategy for development of PIFC] (2012-2014)
13. Raporti Vjetor i Sektorit për Kontroll të Brendshëm dhe Standarde Profesionale i viteve 2011, 2010 dhe 2009



## **Burime sekondare:**

1. Plan i veprimit për realizimin e NPAA për 130 punonjës të ri në njësitë e punëve financiare në kuadër të entiteteve në nivelin qendror, mund të gjeni edhe në [http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen\\_plan\\_fmc.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen_plan_fmc.pdf)
2. Plan i veprimit për realizimin e NPAA për 144 punonjës të ri të revizionit të brendshëm në kuadër të entiteteve në nivelin qendror, mund të gjeni edhe në [http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen\\_plan\\_vr.pdf](http://www.finance.gov.mk/files/u10/Akcionen_plan_vr.pdf)
3. Raporti Vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2011, Shkup, Mars 2012
4. Bogdanovski. Andreja: *Kapitulli 5 – Maqedonia në Almanakun e Vëzhgimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor*, Beograd, 2012, mund të gjeni edhe në: [http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC\\_FINAL\\_WEB2.pdf](http://analyticamk.org/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf)
5. Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitet 2012,2011,2010 dhe 2009
6. Këshilli i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, raporti i vizitës së shtetit në vitin 2010 (mund të gjeni edhe në <http://www.cpt.coe.int/documents/mkd/2012-04-inf-eng.htm>)
7. Edmunds, Timothy (2003) ‘Reforma e Sektorit të Sigurisë: Koncepte dhe Zbatimi’, në Wilhelm N.Germann and Timothy Edmunds (eds) *Drejt Reformave të Sektorit të Sigurisë në Evropën e pas luftës së ftohtë: Kornizë për Vlerësim*.
8. Progres Raporti i BE-së për Republikën e Maqedonisë për vitin 2011
9. Mendimi publik mbi punën e Parlamentit, Instituti për Demokraci “Societas Civilis” & Westminster Foundation, janar 2012, mund të gjeni edhe në <http://www.idscs.org.mk/images/stories/upload/anketi/prezentacija-sobranie-201201.pdf>
10. SIGMA Raporti i Vlerësimit mbi Maqedonisë, maj 2010
11. Departamenti i Shteteve të Bashkuara, Raporte Shtetërore për Prakti-



kat e të Drejtave të Njeriut 2011 (mund të gjeni edhe në <http://www.state.gov/documents/organization/186589.pdf>)

12. Udhëzues për Buxhete (Budget guide) CRPM, mund të gjeni edhe në: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2012/03/VodicvobuzetiMKD.pdf>

## Medie:

1. Dnevnik (2012) Thaçi: Maqedonia dhe Serbia bashkëpunojnë në dëm të Shqiptarëve [Tachi: Macedonia and Serbia cooperate against the Albanians], 22.02.2012 mund të gjeni edhe në <http://dnevnik.mk/default.asp?ItemID=F9C-DC90C7622C24FBB60A181FD70EC73>

2. Dnevnik (2012) Kontrolli Sekret i Shërbimeve Sekrete [Secret control of the secret services], 27.11.2011 mund të gjeni edhe në: <http://www.dnevnik.com.mk/?itemID=BF99804621491D4F9EA4D53A97F6B2F5&arc=1>

3. Kanal 5 (2012) Deputetët do të kërkojnë kolegë me përvojë jashtë shtetit për vëzhgim të përgjimit [MPs will ask experienced colleagues from abroad to help them with the oversight over communication interception], 31.01.2012 mund të gjeni edhe në: <http://kanal5.com.mk/default.aspx?mId=37&egId=13&eventId=86389>

4. Kapital (2012) Opozita e vendosur nëpërmjet Kuvendit të kontrollojë Qeverinë [Opposition determined to control the Government through the Parliament], 05.07.2012, mund të gjeni edhe në: [http://www.kapital.mk/MK/makedonija/86076/opozicijata\\_reshena\\_preku\\_sobraniето\\_da\\_ja\\_kontrolira\\_vladata.aspx](http://www.kapital.mk/MK/makedonija/86076/opozicijata_reshena_preku_sobraniето_da_ja_kontrolira_vladata.aspx)

5. MIA, Agjencia Informative Maqedonase (2012) Besimi në takim me anëtarët e Komitetit për Vëzhgim mbi zbatimin e masave për ndjekje të komunikimeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes (Besimi had meeting with members from Committee supervising communication interception) , mund të gjeni edhe në: <http://www.mia.mk/default.aspx>



[?mId=31&vId=95952239&Id=1&title=%D0%9C%D0%90%D0%9A%D0%95%D0%94%D0%9E%D0%9D%D0%98%D0%88%D0%90+-+%D0%9E%D0%94%D0%91%D0%A0%D0%90%D0%9D%D0%90+%D0%98+%D0%91%D0%95%D0%97%D0%91%D0%95%D0%94%D0%9D%D0%9E%D0%A1%D0%A2](http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=517101026129&id=9&setIzdanie=21985)


6. Nova Makedonija (2010) Maqedonasit përkrahës më të mëdhenj të ushtrive të saja jashtë vendit [Macedonians the biggest supporters of their soldiers abroad] ,17.05.2010 mund të gjeni edhe në: <http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=517101026129&id=9&setIzdanie=21985>

7. Plusinfo (2012) Hera e parë DSZ-ja dorëzon raport para deputetëve, Mijalkov nuk erdhi [DSCI submitted a report to the MPs for the first time, Mijalkov didn't come] 16.05.2012 mund të gjeni edhe në: <http://www.plusinfo.mk/vest/43127/Prvpat-UBK-dostavi-izveshtaj-do-pratenicite-Mijalkov-ne-dojde>

8. Utrinski Vesnik 2012 , Çfarë përmban raporti i DSZ-së në Parlament? [What does the DSCI report for the Parliament consist?], 15.05.2012, mund të gjeni edhe në: <http://www.utrinski.com.mk/?ItemID=C42D9EC98F2D814B8C8A-07A833CC73EC>


## **Intervista:**

1. Intervistë me Vladimir Gjorcev – kryetar i Komitetit për Siguri dhe Mbrojtje, e zhvilluar më 23 korrik 2010;
2. Intervistë me zyrtarë nga sektori publik, zhvilluar më 17.07.2012;
3. Intervistë me zyrtarë nga shërbimet e zbulimit në Maqedoni, zhvilluar më 10.07.2012.



**Shtojca 1**  
 adaptuar the organigrami  
 zyrtar i MPB  
 në: [www.mvr.gov.mk](http://www.mvr.gov.mk)

# SISTEMI PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK AKTORËT KRYESOR







*Kah gjenerata e 2<sup>-të</sup> e*

**Reformave në Sektorin e  
Sigurisë në MAQEDONI**

